

# ANKETA KOMBËTARE MBI QEVERISJEN DHE SIGURINË MJEDISORE

ANALIZA E REZULTATEVE



# ANKETA KOMBËTARE MBI QEVERISJEN DHE SIGURINË MJEDISORE

ANALIZA E REZULTATEVE

**OSCE** Organizata për Siguri dhe  
Bashkëpunim në Evropë  
Prezenca në Shqipëri

Ky dokument u financua, si pjesë e projektit të prezencës së OSBE-së në Shqipëri, "Forcimi i Qeverisjes dhe Sigurisë Mjedisore në Shqipëri", mbështetur nga Qeveritë e Norvegjisë, Francës dhe Italisë. Gjithsesi pikëpamjet e shprehura në të nuk reflektojnë domosdoshmërisht politikat zyrtare të Qeverisë së Norvegjisë, Francës dhe asaj të Italisë.

**Menaxhues të Projektit:** Dr. Elton Qendro  
Menaxher Projekti,  
Zyrtar Vendas për Qeverisjen Mjedisore dhe Vendore,  
Prezenca e OSBE-së në Shqipëri

Ergi Bregasi,  
Asistent Projekti, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri

**Autor:** Ita Bonner PhD (c)

**Statusi:** Nëntor 2023

**Dizajner:** Gejsi Tafa / Kaleidoskope

© 2023 Prezenca e OSBE-së në Shqipëri



**Sqarim:**

Gjetjet, interpretimet dhe përfundimet e shprehura në këtë vlerërim bazë janë tërësisht të autorit dhe nuk duhet t'i atribuohen në asnjë mënyrë prezencës së OSBE-së në Shqipëri.



# TABELA E PËRMBAJTJES

	<b>Përmbledhja ekzekutive</b>	<b>7</b>
<b>1</b>	<b>Hyrje</b>	<b>13</b>
<b>2</b>	<b>Qëllimi dhe metodologjia e aplikuar për zhvillimin e anketës dhe analizën e rezultateve</b>	<b>15</b>
2.1	Qëllimi dhe objektivat e anketës dhe analizës së rezultateve	15
2.2	Kuadri metodologjik	15
2.3	Mbledhja e të dhënave	16
2.4	Metodologjia e kampionimit	16
2.5	Mostra dhe procesi i kampionimit	17
2.6	Limitet e studimit	18
<b>3</b>	<b>Gjetjet e anketës për vlerësimin e dijeve dhe ndërgjegjësimit të publikut rreth qeverisjes dhe sigurisë mjedisore</b>	<b>21</b>
3.1	Të dhënat demografike	21
3.2	Njohja dhe ndërgjegjësimi	22
3.3	Çështjet gjinore dhe shkeljet mjedisore	32
3.4	Roli i korrupsionit në shkeljet mjedisore	37
3.5	Sugjerime për përmirësim	42
<b>4</b>	<b>Konkluzione dhe rekomandime</b>	<b>49</b>
4.1	Ndërgjegjësim dhe shpërndarje e informacionit mjedisor	50
4.2	Ndërgjegjësim për efektin e shkeljeve mjedisore ndaj grave dhe vajzave	50
4.3	Adresimi i rolit të korrupsionit në shkeljet mjedisore	51
4.4	Forcimi i rolit të komunitetit në adresimin e shkeljeve mjedisore	51
	<b>Literatura</b>	<b>52</b>
	<b>Shtojca I. Pyetësi</b>	<b>53</b>
	<b>Lista e tabelave</b>	<b>58</b>
	<b>Lista e figurave</b>	<b>58</b>
	<b>Lista e shkurtimeve</b>	<b>59</b>



# PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

## Në këtë raport paraqitet analiza e thelluar e rezultateve të anketës. Në mënyrë të përmbledhur, gjetjet dhe përfundimit kryesore të kësaj ankete janë:

- Anketa ka një pjesëmarrje më të lartë të grave (61%) krahasuar me burrat (39%), ku grup-mosha 28-37 vjeç përbën pjesën më të madhe të personave që janë përgjigjur (36%).
- Studimi paraqet një mbulim kombëtar me pjesën më të madhe prej 39% të të anketuarve që banojnë në Qarkun e Tiranës, ndjekur nga Qarku i Fierit me 14%. Qarku më pak i përfaqësuar është ai i Vlorës me 2%.

## Njohja e problematikave mjedisore dhe informacioni mjedisor

- 86% e pjesëmarrësve në anketim shprehen jashtëzakonisht të shqetësuar ose të shqetësuar për problematikat mjedisore, ndërkohë që 8% shprehen neutral, 5% pak të shqetësuar dhe vetëm 1% jo të shqetësuar. Shumica e atyre që shprehen "jashtëzakonisht të shqetësuar" kërkojnë informacion çdo ditë, ndërsa ata që shprehen "shumë të shqetësuar" kërkojnë informacion çdo javë. Ndërsa, pjesëmarrësit që shprehen neutral apo jo të shqetësuar kërkojnë informacion më rrallë se një herë në muaj.
- Të pyetur për burimet e informacionit, 62% e personave që përgjigjen deklarojnë se hasin vështirësi në gjetjen e burimeve të besueshme dhe 41% se marrin informacione të ndryshme për të njëjtën çështje nga burime të ndryshme. Në Tiranë, duket se përqindja më e lartë e informacionit vjen nga platformat e mediave sociale (28%), faqet e lajmeve në internet (26%) dhe televizioni (17%). Nga ana tjetër, në qarqe si Gjirokastra dhe Lezha, përqindja e përgjigjeve për përdorimin e platformave të mediave sociale është relativisht më e ulët, duke u përqëndruar më tepër tek televizioni dhe faqet e

lajmeve në internet, respektivisht.

- Problematikat më të mëdha mjedisore me të cilat komunitetet/ zona e tyre përballen janë ndotja e ajrit, e ujërave dhe/ose e tokës (83%), ndjekur nga transporti dhe menaxhimi i mbetjeve (65%), prerja, shkatërrimi dhe/ ose zjarrvënja në pyje (42%), dëmtimi i habitateve dhe/ ose i llojeve të mbrojtura (31%), aktivitete që çojnë në lëshimin e substancave toksike (20%) dhe kryerja e aktiviteteve minerare (20%).
- Të pyetur për mendimin e tyre lidhur me cilin nga problemet konsiderojnë si më domethënës; problemi më domethënës në kuadër të kundërvajtjeve mjedisore duket se është mungesa e ndërgjegjësimit për problematikat mjedisore (53%), mos-reagimi nga institucionet kur një problem raportohet (32%), mungesa e dijeve rreth mënyrës së raportimit (9%), mungesa e informacionit mjedisor (4%) apo edhe diçka tjetër (1%).
- 73% e pjesëmarrësve thonë se kanë përjetuar ose parë kryerjen e një dëmi në mjedisin e zonës së tyre nga persona ose subjekte, ndërkohë që vetëm 43% përqind e tyre thonë se e kanë raportuar këtë tek institucionet zyrtare.
- Në Tiranë, 31% e pjesëmarrësve shprehen se janë të interesuar për të patur më shumë informacion rreth e ndotjes së ajrit, ujërave, dhe tokës, ndërkohë që transporti dhe menaxhimi i mbetjeve zënë 22%, dëmtimi i zonave të mbrojtura dhe llojeve të mbrojtura 18%, dhe prerja, shkatërrimi apo zjarrvënja në pyje 17%. Në Fier, ndotja e ajrit, ujit dhe tokës zënë 12% dhe menaxhimi i mbetjeve 7%. Në qytetet e tjera, si Shkodra dhe Durrësi, tematika të tilla si dëmtimi i habitateve dhe kryerja e aktiviteteve minerare paraqiten si shqetësime domethënëse.
- Koncepti "siguri mjedisore" është koncepti më i vështirë për t'u kuptuar nga publiku (99.91% normë përgjigje), ndjekur nga "qeverisje mjedisore" (99.92% normë përgjigje) dhe "krim mjedisor" (99.94% normë përgjigje).

### **Perceptimi mbi ndryshimin e ndikimit të shkeljeve mjedisore sipas gjinisë**

- Shumica prej 79% vlerëson se të gjitha grupet preken në mënyrë të njëjtë nga shkeljet apo krimet mjedisore, ndjekur nga 18% që shprehen se gratë dhe vajzat preken në mënyrë më të theksuar dhe 3% shprehen burrat dhe djemtë. Perceptimi i grave për ndikimin që shkeljet apo krimet mjedisore kanë ndaj gjinisë së tyre është i ndryshëm nga ai i burrave, ku prej të anketuarve që janë përgjigjur se më të prekura janë gratë dhe vajzat, 83% janë gra dhe 17% janë burra.

### **Perceptimi mbi ndikimin e korrupsionit në rritjen e krimeve ndaj mjedisit**

- 94% besojnë se korrupsioni në institucionet publike ka ndikim në shkeljet/ krimet mjedisore, përkundrajt 6% që mendojnë se nuk ka ndikim. 76% e të anketuarve shprehen se kanë hasur në raste kur zbatimi i dobët i legjislacionit mjedisor vjen për shkak të korrupsionit, përkundrajt 24% që thonë se nuk kanë hasur raste të tilla.
- 10% e banorëve të Qarkut Tiranë konfirmojnë se kanë përjetuar ose dijnë për raste të korrupsionit në zonën e tyre të banimit. Në anën tjetër, qytetarët e qyteteve si Berati, Dibra, Durrësi dhe Lezha raportojnë një përjetim të ulët të rasteve të tilla, secila me 1%. Po ashtu, 23% e pjesëmarrësve banues në Qarkun Tiranë përgjigjen se kanë dëgjuar për raste të korrupsionit përmes miqve ose familjarëve, duke treguar për një ndikim të fuqishëm të informacionit të përhapur nga kanale jozyrtare.
- 90% e të anketuarve mendojnë se adresimi i korrupsionit është thelbësor për të përmirësuar qeverisjen mjedisore dhe për të parandaluar shkeljet mjedisore.
- 94% e të anketuarve shprehen se janë në dijeni për raste kur individë ose biznese kanë përdorur ryshfet për t'iu shmangur rregullave ose ndëshkimeve mjedisore, por 79% deklarojnë se nuk e kanë raportur këtë gjë.
- 90% e të anketuarve mendojnë se kryerja e fushatave të ndërgjegjësimit dhe nismave për edukim të lidhura me qeverisjen dhe sigurinë mjedisore do të ndikojnë pozitivisht në angazhimin e publikut në përpjekjet për mbrojtjen e mjedisit dhe raportimin e dëmeve ose krimeve në mjedis.
- 86% e publikut të pyetur janë të hapur ose disi të hapur për të marrë pjesë aktive në nismat lokale për rritjen e sigurisë dhe mirë-qeverisjen mjedisore ose


për të qenë vullnetar në organizata mjedisore.

Në pyetjet e hapura, publiku propozon informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut si një nga mjetet më efektive për të forcuar angazhimin dhe pjesëmarrjen qytetare në qeverisjen dhe sigurinë mjedisore, duke mbështetur më tej zbatimin e legjislacionit mjedisor në Shqipëri.



# PËRMBLEDHJE GRAFIKE

## GJINIA E PJESËMARRËSVE NË STUDIM



## MOSHA E PJESËMARRËSVE NË ANKETË



## PERCEPTIMI MBI GJINITË E PREKURA NGA SHKELJET APO KRIMET MJEDISORE



79% TË GJITHA GRUPET PREKEN NË MËNYRË TË NJËTË 18% GRATË DHE VAJZAT PREKEN NË MËNYRË MË TË THEKSUAR  
3% BURRAT DHE DJEMTË PREKEN NË MËNYRË MË TË THEKSUAR

### RAPORTIME MBI RASTET E KORRUPSIONIT

94% E TË ANKETUARVE NË DIJENI PËR RASTET E RYSHFETEVE PËR T'IU SHMANGUR RREGULLAVE OSE NDËSHKIMEVE MJEDISORE

76% E TË ANKETUARVE DEKLAROJNË SE NUK E KANË RAPORTUR KËTË GJË

### AKTIVIZMI NË NISMA MJEDISORE

90% E TË ANKETUARVE PRO FUSHATAVE TË NDËRGJEGJËSIMIT DHE NISMAVE PËR EDUKIM PËR SIGURINË MJEDISORE

86% E PUBLIKUT TË PYETUR JANË PRO PJESËMARRJES AKTIVE NË NISMAT LOKALE PËR RRITJEN E SIGURISË MJEDISORE

## NDIKIMI I KORRUPSIONIT NË ZBATIMIN E LIGJIT PËR SHKELJE / KRIME MJEDISORE

94% E TË ANKETUARVE BESOJNË SE KORRUPSIONI NË INSTITUCIONET PUBLIKE KA NDIKIM NË SHKELJET/ KRIMET MJEDISORE

6% E TË ANKETUARVE MENDOJNË SE KORRUPSIONI NË INSTITUCIONET PUBLIKE NUK KA NDIKIM NË SHKELJET/ KRIMET MJEDISORE

76% E TË ANKETUARVE SHPREHEN SE KANË HASUR NË RASTE KUR ZBATIMI I DOBËT I LEGJISLACIONIT MJEDISOR VJEN PËR SHKAK TË KORRUPSIONIT

24% E TË ANKETUARVE THONË SE NUK KANË HASUR RASTE TË ZBATIMI TË DOBËT TË LEGJISLACIONIT MJEDISOR PËR SHKAK TË KORRUPSIONIT



## PROBLEMATIKAT MË TË MËDHA MJEDISORE ME TË CILAT PËRBALLEN



83%

NDOTJA E AJRIT, E UJËRAVE DHE/OSE E TOKËS

DËMTIMI I HABITATEVE DHE/OSE I LLOJEVE TË MBROJTURA

31%



65%

TRANSPORTI DHE MENAXHIMI I MBETJEVE

AKTIVITETE QË ÇOJNË NË LËSHIMIN E SUBSTANCAVE TOKSIKE

20%



42%

PRERJA, SHKATËRRIMI DHE/OSE ZJARRËVËNIA NË PYJE

KRYERJA E AKTIVITETEVE MINERARE

20%



## PROBLEMET QË KONSIDEROHEN MË DOMETHËNËSE NË KUADËR TË KUNDRAVAJTJEVE MJEDISORE

53%

MUNGESA E NDËRGJEGJËSIMIT PËR PROBLEMATIKAT MJEDISORE

32%

MOS-REAGIMI NGA INSTITUCIONET KUR NJË PROBLEM RAPORTOHET

9%

MUNGESA E DIJEVE RRETH MËNYRËS SË RAPORTIMIT

4%

MUNGESA E INFORMACIONIT MJEDISOR

1%

DIÇKA TJETËR

## NIVELI I SHQETËSIMIT I TË ANKETUARVE PËR PROBLEMATIKAT MJEDISORE

86%

JASHTËZAKONISHT TË SHQETËSUAR OSE TË SHQETËSUAR

8%

NEUTRAL

5%

PAK TË SHQETËSUAR

1%

JO TË SHQETËSUAR

■ SHUMICA E ATYRE QË SHPREHEN "JASHTËZAKONISHT TË SHQETËSUAR" KËRKOJNË INFORMACION ÇDO DITË  
■ ATA QË SHPREHEN "SHUMË TË SHQETËSUAR" KËRKOJNË INFORMACION ÇDO JAVË

## BURIMET E INFORMACIONIT MBI ÇËSHTJET MJEDISORE



62%

E PERSONAVE QË PËRGJIGJEN DEKLAROJNË SE HASIN VËSHTIRËSI NË GJETJEN E BURIMEVE TË BESUESHME



41%

MARRIN INFORMACIONE TË NDRYSHME PËR TË NJËJTËN ÇËSHTJE NGA BURIME TË NDRYSHME

## PËRJETIMI DHE RAPORTIMI I DËMEVE NDAJ MJEDISIT NGA TË ANKETUARIT

73%

E PJESËMARRËSVE THONË SË KANË PËRJETUAR OSE PARË KRYERJEN E NJË DËMI NË MJEDISIN E ZONËS SË TYRE NGA PERSONA OSE SUBJEKTE

41%

E PJESËMARRËSVE THONË SE E KANË RAPORTUAR KËTË TEK INSTITUCIONET ZYRTARE

The image features a large, white, stylized number '1' positioned on the right side. The background is a gradient from light blue on the left to bright orange on the right. A pattern of small, light blue dots is scattered across the entire background. At the bottom, there is a series of thin, white, concentric curved lines that form a semi-circular arc, resembling a fingerprint or a stylized wave. The overall aesthetic is modern and digital.

1

Megjithëse një territor relativisht i vogël, Shqipëria zotëron një larmi të gjerë ekosistemesh dhe burime të bollshme natyrore, të cilat mbështesin dhe përmirësojnë cilësinë e jetës. Paralelisht me rëndësinë e zbatimit të legjislacionit mjedisor dhe kapaciteteve efektive e të forcuar të institucioneve mjedisore, një mekanizëm tjetër po aq i rëndësishëm për qëndrueshmërinë dhe mbrojtjen e këtyre burimeve është pjesëmarrja dhe angazhimi i vazhdueshëm i qytetarëve në qeverisjen mjedisore.

**Pjesëmarrja dhe forcimi i angazhimit qytetar në këtë kuadër është thelbësisht i nevojshëm në qeverisjen mjedisore.** Pjesëmarrja e vazhdueshme i mundëson qytetarëve që të njohin dhe të identifikojnë problematikat mjedisore dhe të jenë në përputheshmëri me ligjet përkatëse që sigurojnë mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit, si dhe të vendosin prioritetet për zhvillimin e politikave mjedisore gjithëpërfshirëse.

Në këtë linjë, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, si pjesë e veprimtarisë së saj gjithëpërfshirëse në fushën e qeverisjes dhe sigurisë mjedisore në Shqipëri, në bashkëpunim me institucionet, organizatat e shoqërisë civile dhe media, është duke punuar për të forcuar kuadrin institucional dhe ligjor mjedisor, përmirësimin e kapaciteteve dhe ekspertizës teknike për trajtimin e krimit mjedisor, si dhe rritjen e ndërgjegjësimit dhe angazhimit mjedisor qytetar.

Për këtë të fundit, Prezenca e OSBE-së zhvilloi një anketim kombëtar, gjatë Shtator – Tetor 2023, për të vlerësuar shkallën e ndërgjegjësimit, perceptimit dhe njohurive të publikut të gjerë mbi çështjet e qeverisjes dhe sigurisë mjedisore, zbatimit dhe pajtueshmërisë me legjislacionin përkatës në nivel kombëtar. Gjithashtu anketa dhe analiza e rezultateve trajton dhe çështje të tjera të rëndësishme si ndërlidhja midis ndryshimit të ndikimit të krimit mjedisor sipas gjinisë, rolin që luan

korupsioni në krimet ndaj mjedisit, si dhe mundësitë për përmirësimin e informacionit dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në veprimtaritë mjedisore.

Njohja e shkallës së ndërgjegjësimit dhe perceptimit të qytetarëve mbi çështjet e qeverisjes dhe sigurisë mjedisore është e rëndësishme kryesisht:

1. për të identifikuar fushat e nevojshme mjedisore për të cilat kërkohet ndërgjegjësim dhe informim i mëtejshëm mjedisor.
2. për të përmirësuar dhe zgjedhur mjete efektive për komunikimin dhe ndërgjegjësimin mjedisor qytetar me qëllim rritjen e angazhimit të tyre në qeverisjen mjedisore;
3. për të krijuar fushata ose veprimtari mjedisore edukuese dhe ndërgjegjësuese të posaçme për të rritur angazhimin qytetar në qeverisjen mjedisore dhe kuptimin e tyre mbi rëndësinë e sigurisë mjedisore.

Zhvillimi i kësaj ankete është kryer përmes formave elektronike të komunikimit dhe ka shënuar kryesisht pjesëmarrje të gjerë të studenteve.

Përfundimet dhe konkluzionet kryesore të këtij raporti do të mbështesin Prezencën e OSBE-së në ndërtimin e fushatave ndërgjegjësuese mjedisore për publikun, për të adresuar në mënyrë efektive fushat kryesore të identifikuar ku nevojitet më tepër ndërgjegjësim dhe informim mjedisor. Përtej kësaj, gjetjet e këtij raporti i shërbejnë dhe mund të përdoren nga çdo aktor mjedisor, qoftë institucion, organizatë e shoqërisë civile apo media, për hartimin e fushatave ndërgjegjësuese, krijimin e mjeteve edukative mjedisore apo komunikimin publik mjedisor



# QËLLIMI DHE METODOLOGJIA E APLIKUAR

## 2.1. Qëllimi dhe objektivat e anketës dhe analizës së rezultateve

Qëllimi kryesor i këtij raporti është interpretimi dhe analizimi i rezultateve të anketës publike kombëtare, zhvilluar nga Prezenca e OSBE-së, përmes së cilës mundësohet një analizë gjithëpërfshirëse e shkallës së ndërgjegjësimit, njohurive, dhe perceptimit të publikut mbi çështjet e qeverisjes dhe sigurisë mjedisore, zbatimit dhe pajtueshmërisë me legjislacionin përkatës në nivel kombëtar.

Ndër të tjera, fushat kryesore janë trajtuar në anketë dhe analizohen në këtë raport janë si më poshtë të renditura:

1. Ndërgjegjësimi i publikut lidhur me çështjet e qeverisjes dhe sigurisë mjedisore
2. Ndërlidhja e çështjeve gjinore dhe shkeljeve mjedisore
3. Roli i korrupsionit në shkeljet mjedisore
4. Përmirësimi i njohurive dhe pjesëmarrjes aktive të qytetarëve

## 2.2. Kuadri metodologjik

Analiza e kryer paraprakisht sugjeron përdorimin e një qasje e kombinuar për përmbushjen e këtij studimi. Metodologjia e zbatuar bazohet kryesisht në metodën sasiore dhe përfshin kombinimin e mbledhjes së të dhënave parësore dhe dytësore, kampionimin sasior, validimin, analizën sasiore dhe cilësore, duke zbatuar përgjatë gjithë procesit të studimit konsideratat etike të përcaktuara nga organizmat ndërkombëtar<sup>1</sup>.

Siç tregohet në nën-çështjen tre në vijim, përmbajtja e anketës dhe e studimit është grupuar në indikatorë të veçantë sipas çështjeve kryesore të ndërgjegjësimit të publikut lidhur me qeverisjen dhe sigurisë mjedisore, ndërlidhjen e çështjeve gjinore me shkeljet mjedisore, rolit të korrupsionit në shkeljet mjedisore dhe rekomandimeve për përmirësimin e njohurive të publikut.

Anketimi është bazuar në një mostër përfaqësuese,

1. UNICEF Procedure On Ethical Standards In Research, Evaluation, Data Collection And Analysis (2021)

Tabela 1. Fushat kryesore të vlerësimit dhe indikatorët përkatës

Fushat kryesore	Treguesit matës
1. Ndërgjegjësimi i publikut lidhur me çështjet e qeverisjes dhe sigurisë mjedisore	A. Njohja nga publiku i problematikave mjedisore
	B. Siguria dhe qeverisja mjedisore
2. Ndërlidhja e çështjeve gjinore dhe shkeljeve mjedisore	C. Ndikimi i shkeljeve mjedisore tek vajzat dhe gratë
	D. Krijimi i politikave të dedikuara për të përfshirë e çështjet gjinore
3. Roli i korrupsionit në shkeljet mjedisore	E. Ndërlidhja e korrupsionit me shkeljet mjedisore
	F. Roli i aktorëve shtetëror dhe jo-shtetëror në kontekstin e korrupsionit dhe shkeljeve mjedisore
4. Përmirësimi i njohurive dhe pjesëmarrjes aktive të qytetarëve	G. Roli i qytetarëve në qeverisjen dhe sigurinë mjedisore
	H. Rekomandime për përmirësimin e përcjelljes së informacionit

Figura 1. Kuadri metodologjik i zbatuar



të besueshme shkencërisht me interval besimi 95% dhe marzh gabimi  $\pm 5\%$ .

Kjo qasje siguroi analizën e dijes dhe ndërgjegjësimit të publikut të gjerë, duke lejuar arritjen e rezultateve dhe rekomandimeve për një fushatë ndërgjegjësimi gjithëpërfshirëse në nivel kombëtar.

### 2.3. Mbledhja e të dhënave

Për të siguruar një panoramë të përgjithshme dhe rezultate të krahsueshme, të dhënat janë mbledhur si nga burime parësore, ashtu edhe nga burime dytësore siç paraqitet më poshtë.

Burimet dytësore të të dhënave përfshijnë:

- **Analizë e dokumenteve të brendshme.** Ky grup dokumentesh përfshin studime, raporte, prezantime dhe materiale të tjera të mundësuar nga Prezenca e OSBE në Shqipëri. Këto materiale përmbajnë informacion relevant të lidhur me shtrirjen e projektit.
- **Analizë e dokumenteve të jashtme.** Ky grup dokumentesh përfshin informacion të mbledhur nga raporte apo studime të hapura për publikun të lidhura me këto tematika nga organizata të tjera si BE, UN dhe agjencitë e saj, GIZ, etj., si edhe organizata kombëtare dhe lokale.
- **Informacione të publikuara nga institucionet publike.** Këto dokumente përfshijnë studime, raporte apo të dhëna të publikuara nga institucione ose agjenci shtetërore të tilla si Prokuroria e Përgjithshme, INSTAT, Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, etj.
- **Punime hulumtuese/ kërkimore.** Këto materiale përfshijnë studime të kryera nga institucione akademike ose organizata kërkimore.

Burimet parësore të të dhënave:

Përfituesit e drejtpërdrejtë të fushatës së ndërgjegjësimit në nivel kombëtar do të jenë të gjithë

qytetarët që banojnë në Shqipëri. Projekti "Forcimi i Qeverisjes dhe Sigurisë Mjedisore në Shqipëri" përcakton si një nga qëllimet kryesore të tij, rritjen e angazhimit të publikut të gjerë ndaj sigurisë dhe qeverisjes mjedisore. Në linjë me qëllimin dhe në kuatër të këtij vlerësimi, grupet e synuara të anketës janë të rinjtë, përfaqësues të organizatave jo-fitimprurëse, përfaqësues të institucioneve publike, bizneseve private, e në tërësi, publiku i gjerë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Ky vlerësim është kryer duke përdorur një anketë elektronike si mjet studimi. Individët pjesë e grupeve të synuara janë arritur duke përdorur metodën sasiore (pyetësori), përmes kanaleve të ndryshme të rrjeteve sociale, shpërndarjes në aplikacionet e komunikimit (WhatsApp, Viber, Signal, etj.), postës elektronike të drejtpërdrejt, etj. Për të patur një pamje më gjithëpërfshirëse është synuar të arrihen qytetarë të moshave të ndryshme, banorë në zona gjysmë-rurale dhe rurale duke kryer anketime ballë-për-ballë në terren.

### 2.4. Metodologjia e kampionimit

Metodologjia e përdorur për të kryer anketimin është **kampionimi i thjeshtë i rastësishëm**. Kjo metodë është provuar e përshtatshme për studime sasiore në shkencat sociale<sup>2</sup>, pasi kampionimi i rastësishëm ndihmon për të kompensuar efektet e faktorëve të njohur dhe të panjohur. Përzgjedhja e kësaj metode është bërë për të siguruar që çdo individ në popullatë të ketë mundësi të

2. Stockemer, D., Stockemer, G., & Glaeser. (2019). Quantitative methods for the social sciences (Vol. 50, p. 185). Quantitative methods for the social sciences: Springer International Publishing



barabartë për t'u përzgjedhur për kampionim<sup>3</sup>. Për më tepër, kjo metodë ofron një përfaqësim të drejtë dhe të paanshëm të të intervistuarve<sup>4</sup>. Në kushtet e anketimit elektronik, kohës së kufizuar dhe mungesës së pranisë fizike të intervistuesve në terren, kjo metodologji ofton të dhëna të besueshme dhe gjithpërfshirëse.

Kampionimi i thjeshtë i rastësishëm është mjaft i përdorur në proceset e anketimit dhe punë hulumtuese sasiorë<sup>5</sup>. Ndër avantazhet e kësaj metodologjie përmendim:

- Në nivel popullate, **të gjithë qytetarët kanë mundësi të barabarta për të marrë pjesë në studim**. Për më tepër, në kushtet kur anketimi kryhet elektronikisht, kjo metodologji është veçanërisht e përshtatshme.
- Përzgjedhja e personave që marrin pjesë në anketim është **e paanshme**, e cila lejon ruajtjen e standardeve etike në mbledhjen, vlerësimin dhe analizën e të dhënave.
- Zbatimi i saj është **më i shpejtë dhe efektiv në kosto**. Shpërndarja e anketës elektronikisht bën të mundur arritjen e një numri më të lartë qytetarësh për njësi kohe duke ndikuar njëkohësisht në uljen e kostos për zhvillimin e një studimi në nivel kombëtar, si dhe duke siguruar një gjurmë të karbonit më të ulët krahasuar me pyetësorët ballë-për-ballë.

Nisur nga fakti se pyetësi mund të arrij çdo qytetar që ka lidhje interneti dhe një pajisje kompjuterike apo telefon inteligjent, gjetja e personave që duan të marrin pjesë në anketim është potencialisht më e lehtë.

## 2.5. Mostra dhe procesi i kampionimit

Kampionimi është kryer në nivel kombëtar, vetëm për persona mbi moshën 18 vjeç. Për shkak të ndarjes së grupmohave në intervalin, 15 deri në 19 vjeç nga INSTAT, si referencë për numrin total të popullsisë është marrë lista e zgjedhëzve për vitin 2019 e publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, e cila bazohet në të dhënat e Zyrës së Gjendjes Civile në nivel bashkie dhe qarku. Në tabelën 2 paraqitet numri i popullsisë në nivel qarku, ku totali i popullsisë është 3,523,953 qytetarë mbi moshën 18 vjeç. Kriteri i përzgjedhjes së personave në moshë madhore përputhet plotësisht me kërkesat për anketim të OSBE dhe konsideratat etike për studime të këtij lloji.

Për të përcaktuar numrin përfundimtar të mostrës së kampionimit është përdorur formula Cochran e modifikuar për popullatat me numër të përcaktuar (pra, numër jo të pafundëm), e cila është e përshtatshme për popullata të mëdha. Duke përdorur një interval besueshmërie 95% dhe marzh gabimi  $\pm 5\%$  rezulton se nevojiten **385 vëzhgime** në nivel kombëtar.

Për shkak të limiteve të këtij lloji studimi në kontekstin e Shqipërisë (*referohu nën-çështjes 2.5 "Limitet e studimit"*), është parë nevoja për t'u përshtatur përgjatë studimit. Pas aprovimit të stafit të projektit pranë OSBE, duke ruajtur besueshmërinë shkencore, periudha e anketimit u zgjat me dy javë dhe numri i të anketuarve u ul në 318 persona. Bazuar në literaturën shkencore<sup>6</sup>, rezultati është i besueshëm shkencërisht kur arrihet numri i individëve mbi të cilin do të merren vazhdimisht të njëjtat përgjigje. Duke qenë se plotësimi i pyetësorit të anketës është kryer si elektronikisht, ashtu edhe ballë-për-ballë, të dhënat tregojnë se ky numër është arritur e rrjedhimisht të dhënat e përfutuara janë të besueshme shkencërisht.

Plotësimi i pyetësorit të anketës është kryer përgjatë 6 javëve elektronikisht, nga të cilat edhe 4 ditëve ballë-për-ballë (datat 7-8 dhe 14-15 tetor 2023). Rezultatet tregojnë se studimi ka mbuluar të gjithë qarqet në Republikën e Shqipërisë. Tabela nr. 2 më lart tregon numrin total dhe përqindjen e përgjigjeve që janë marr në secilin qark.

3. Acharya, A. S., Prakash, A., Saxena, P., & Nigam, A. (2013). Sampling: Èhy and hoë of it. *Indian Journal of Medical Specialties*, 4(2), 330-333. DOI: 10.7713/ijms.2013.0032

4. Sharma, G. (2017). Pros and cons of different sampling techniques. *International journal of applied research*, 3(7), 749-752. <https://www.allresearchjournal.com/archives/2017/vol3issue7/PartK/3-7-69-542.pdf>

5. Rahi, S. (2017). Research design and methods: A systematic revieë of research paradigms, sampling issues and instruments development. *International Journal of Economics & Management Sciences*, 6(2), 1-5. DOI: 10.4172/2162-6359.1000403

6. Griffin, A., Barczak, G. Effective revieëing for conceptual journal submissions. *AMS Rev* 10, 36-48 (2020). <https://doi.org/10.1007/s13162-020-00162-z>

Tabela 2. Popullsia e Shqipërisë në nivel qarku (KQZ, 2019)

Nr.	Qarku	Popullsia	Nr. total i të anketuarve	Përqindja e të anketuarve
1	Berat	182,384	13	4%
2	Dibër	131,454	8	3%
3	Durrës	349,365	15	5%
4	Elbasan	343,258	15	5%
5	Fier	399,550	45	14%
6	Gjirokastrë	123,447	21	7%
7	Korçë	283,169	12	4%
8	Kukës	82,038	9	3%
9	Lezhë	171,678	12	4%
10	Shkodër	269,021	39	12%
11	Tiranë	886,631	124	39%
12	Vlorë	301,958	5	2%
<b>Totali</b>		<b>3,523,953</b>	<b>318</b>	<b>100%</b>

## 2.6. Limited e studimit

Ky studim është zbatuar duke marrë një nivel besimi 95% dhe marzh gabimi  $\pm 5\%$ . Në interpretimin e gjetjeve të këtij studimi, është e rëndësishme të njohim disa kufizime që mund të ndikojnë në aftësinë për të përgjithësuar rezultatet e përfuara. Në këtë kontekst është me vend të përmendet se një nivel besueshmërie prej 95% do të thotë që ekziston një shans 5% për gabim. Për këtë arsye, lexuesit dhe hulumtuesit duhet të tregojnë kujdes në interpretimin e këtyre rezultateve, duke patur parasysh mundësinë e gabimeve në përgjithësim.

Studimi bazohet në një anketë në formë elektronike, sukcesi i së cilës varet nga të paturit të një pajisje kompjuterike/ telefonike inteligjente dhe lidhje internet. Kjo mund të ndikojë në përfaqësimin e përgjithshëm të personave që banojnë në zona të largëta rurale ku lidhja internet mungon apo është e dobët, përfaqësimin e moshave të mëdha të cilët nuk kanë pajisje inteligjente apo nuk kanë njohuri për përdorimin e tyre, si dhe në arritjen e përsosur me të ardhura të ulta të cilët nuk zotërojnë pajisje inteligjente. Për të adresuar këtë, përgjatë studimit, një total prej 38 intervistash është zhvilluar ballë-për-ballë në terren.

Studimet e ardhshme mund të përdorin masa shtesë ose të kombinojnë të dhëna për të forcuar besueshmërinë e gjetjeve. Megjithatë, pavarësisht

këtyre kufizimeve, studimi i kryer sjell njohuri të vlefshme për situatën ekzistuese dhe vendos një bazë për studime të ngjashme në të ardhmen.



The image features a large, white, stylized number '3' centered on a blue background. The background is filled with a pattern of small, light blue dots. At the bottom of the image, there are several thin, white, curved lines that sweep across the width of the page, creating a sense of motion or a decorative flourish. The overall aesthetic is clean and modern.

3

# GJETJET E ANKETËS

Ky kapitull paraqet analizën e kombinuar të të dhënave sasiore për anketën e hapur gjithëpërfshirëse për vlerësimin e dijeve dhe ndërgjegjësimit të publikut rreth qeverisjes dhe sigurisë mjedisore.

Nën-çështja e parë paraqet të dhënat demografike të pjesëmarrësve në anketë duke përfshirë gjininë, grup-moshën, qarkun e banimit, statusin e punësimit dhe nivelin arsimor. Nën-çështja e dytë shpjegon të dhënat për njohjen dhe ndërgjegjësimin e publikut ndaj tematikave të qeverisjes dhe sigurisë mjedisore, ndjekur nga nën-çështja e tretë e cila paraqet perceptimin e publikut për çështjet gjinore dhe shkeljet dhe/ ose krimet mjedisore. Nën-çështja e katërt përfshin rolin e korrupsionit në shkeljet dhe/ ose krimet mjedisore sipas perceptimit, dijeve dhe ndërgjegjësimit të publikut. Nën-çështja e pestë përmbledh sugjerimet e publikut për përmirësim dhe rritje të dijeve dhe ndërgjegjësimit të qytetarëve rreth tematikave të qeverisjes dhe sigurisë mjedisore.

## 3.1. Të dhënat demografike

Rezultatet tregojnë një pjesëmarrje më të lartë të grave (61%) krahasuar me burrat (39%) në këtë studim (Fig. 2).

Grup-mosha është një tregues i rëndësishëm për diversitetin e dijeve, perceptimit, ndërgjegjësimit dhe informimit të publikut të gjerë. Siç tregohet në figurën 3, grup-mosha 28-37 vjeç përbën pjesën më të madhe të pjesëmarrësve në anketë (36%), ndjekur nga 18-27 vjeç (25%), 38-47 vjeç (18%), 48-57 vjeç (14%), e me përqindjen më të ulët personat e moshës 58-67 vjeç (6%) dhe 68-77 vjeç (1%). Ky segmentim i grupmoshës na ndihmon të kuptojmë ndërveprimin dhe ndryshimet potenciale në vlerësimet dhe perspektivat mbi çështjet e sigurisë dhe qeverisjes mjedisore.

Rajone, qarqe apo bashki të ndryshme në Shqipëri mund të kenë problematika dhe shqetësime të ndryshme për situatën mjedisore. Për të kuptuar nga njëra anë situatën e përgjithshme në nivel kombëtar, e

Figura 2. Gjinia e personave që janë përgjigjur






Figura 3. Grup-mosha





nga ana tjetër atë në nivel qarku e bashkie, anketa ka mbledhur të dhëna për qarkun ku banojnë të anketuarit (Fig. 4). Pjesa më e madhe prej 39% banojnë në Qarkun e Tiranës, ndjekur nga Qarku i Fierit me 14%, Qarku i Shkodrës me 12% dhe Qarku i Gjirokastrës me 7%. Qarku i Durrësit dhe ai i Elbasanit paraqiten me 5% secili. Qarku i Beratit, i Korçës dhe i Lezhës përfaqësojnë 4% secili, ndërsa Qarku i Dibrës dhe Kukësit përfaqësojnë 3% secili. Qarku më pak i përfaqësuar është ai i Vlorës me 2%.

Të dhënat e mësipërme tregojnë për një mbulim në nivel kombëtar të anketës, përfshirje të së gjithë qarqeve, grup-moshave dhe të të dy gjinive. Luhatja e përfaqësimit në numër individësh të secilit qark mund të lidhet me variacionin e popullsisë totale për secilin qark. Pra, Qarku i Tiranës, duke patur popullsinë më të lartë në Shqipëri (referohu Tabelës nr. 2 më lart), ka edhe përfaqësimin më të lartë. Po ashtu, duke qenë se grup-mosha me përfaqësim më të lartë në këtë studim është ajo 18-37 vjeç, e cila është përgjithësisht mosha studentore mund të kuptojmë se formati elektronik i pyetësorit mund të këtë ndikuar në afrimin e tyre. Informacioni i mbledhur në këtë seksion paraqet rëndësi për të kuptuar perspektivat dhe vlerësimet e ndryshme në qarqe të ndryshme të Shqipërisë.

Siç tregohet në figurën 5, 70% e pjesëmarrësve në anketë janë të punësuar me kohë të plotë, ndjekur nga 10% student dhe 10% të vetë-punësuar, 3% të punësuar me kohë të pjesshme, 3% të papunë, 2% në pension dhe

1% që janë përgjigjur tjetër. Vihet re se ata që përgjigjen tjetër janë të 2-punësuar, persona që janë në procesin e diplomimit, etj.

Ndër ata që kanë zgjedhur të deklarojnë profesionin e tyre dallojmë gazetarë, inxhinierë mjedisi, punonjës të organizatave jo-fitimprurëse, mësues, etj.

Sa i takon nivelit më të lartë të edukimit të arritur (Fig. 6), rezultatet tregojnë se pjesa më e madhe e pjesëmarrësve në anketë ka një diplomë universitare (48%), ndjekur nga ata që kanë arritur diplomën pas-universitare të cilët përbëjnë një përqindje të rëndësishme (35%). Këto grupe kanë potencialin për një shkallë më të lartë të informacionit dhe ndërgjegjësimit. 11% deklaroi se ka përfunduar shkollën e mesme, 4% deklaroi se ka përfunduar një shkollë profesionale, 1% ka përfunduar shkollën fillore ose tetë/nëntë-vjeçare dhe 1% është përgjigjur tjetër. Në grupin e fundit gjejmë persona që kanë përfunduar studime doktorate, etj.

### 3.2. Njohja dhe ndërgjegjësimi

Identifikimi, dallimi dhe raportimi i shkeljeve mjedisore vijnë si rezultat i njohjes së politikave, rregulloreve, e si rrjedhim shkeljeve. Për këtë arsye, njohja dhe ndërgjegjësimi i publikut lidhur me sigurinë dhe qeverisjen mjedisore është kyç në përmirësimin



Figura 5. Punësimi





Figura 6. Niveli më i lartë i edukimit të arritur



e situatës së përgjithshme mjedisore në Shqipëri. Kjo nën-çështje paraqet ndjeshmërinë e publikut ndaj problematikave mjedisore, raportimin e shkeljeve mjedisore, të kuptuarit e koncepteve “qeverisje mjedisore”, “siguri mjedisore”, “krim mjedisor”, etj.

Publiku është pyetur sa të shqetësuar janë për problematikat mjedisore (Fig. 7). Në mënyrë domethënëse, 86% e pjesëmarrësve në anketim shprehen jashtëzakonisht të shqetësuar ose të shqetësuar, ndërkohë që 8% shprehen neutral 5% pak të shqetësuar dhe vetëm 1% jo të shqetësuar.

Rezultatet e kësaj pyetje tregojnë një nivel të lartë të publikut për çështjet mjedisore në Shqipëri. Edhe pse në përqindje të vogël, niveli i ulët i shqetësimit mund të jetë rezultat i mungesës së njohurive, ndërgjegjësimit ose interesit të përgjithshëm ndaj mjedisit. Rezultatet e kësaj pyetje formojnë një bazë të fortë për të ndërmarrë veprime të mëtejshme për të përmirësuar ndërgjegjësimin dhe për të adresuar

nevojat dhe shqetësimet e publikut në këtë fushë.

Nga analiza e të dhënave, shihet se ka dallim në nivelet e shqetësimit rreth problematikave mjedisore midis gjinive. 52% e grave thonë se janë jashtëzakonisht ose shumë të shqetësuar, krahasuar me 33% të burrave. Ky dallim në perceptimin e shqetësimit ndërmjet gjinive mund të jetë i lidhur me perceptimet tyre ndaj impaktit të problemeve mjedisore në jetën e tyre të përditshme.

Sa i takon perceptimit neutral apo mungesës së shqetësimit vërejmë se nuk ka ndryshim domethënës ndërmjet gjinive. Interesant të përmendet është se një pjesëmarrës në anketë që është shprehur “tjetër” sa i takon gjinisë, shprehet shumë i/e shqetësuar.

Të pyetur sa shpesh kërkojnë informacion rreth çështjeve mjedisore (Fig. 9), shumica prej 33% e pjesëmarrësve shpreh një interes të qëndrueshëm duke kërkuar informacion çdo javë, ndjekur nga 23% që

Figura 7. Sa i/e shqetësuar jeni për problematikat mjedisore?





Figura 8. Niveli i shqetësimit për problematikat mjedisore sipas gjinisë



kërkojnë informacion çdo muaj, 22% çdo ditë, 20% më rrallë se një herë në muaj, dhe vetëm 2% që shprehen se nuk kërkojnë në mënyrë proaktive.

Bazuar në rezultatet e përfuara, vërehet një ndarje e theksuar e pjesëmarrësve në frekuencën me të cilën ata kërkojnë informacion rreth çështjeve mjedisore dhe një shkallë të ndryshme të përkushtimit ndaj kërkimit proaktiv të informacionit rreth çështjeve mjedisore nga ana e pjesëmarrësve. Ky informacion është i rëndësishëm për të kuptuar se nevojitet të përmirësohen strategjitë e informimit dhe edukimit për

publikun në lidhje me këto çështje.

Të dhënat e paraqitura në fig.10 mbështesin gjetjet e fig. 7 dhe 9, ku vërehet se shumica e pjesëmarrësve në anketë që shprehen "jashtëzakonisht të shqetësuar" kërkojnë informacion çdo ditë, ndërsa ata që shprehen "shumë të shqetësuar" kërkojnë informacion çdo javë. Ndërsa, pjesëmarrësit që shprehen neutral apo jo të shqetësuar kërkojnë informacion më rrallë se një herë në muaj.

Interneti duket se është burimi kryesor përmes

Figura 9. Sa shpesh kërkon informacion rreth çështjeve mjedisore?





Figura 10. Shpeshtia e kërkimit të informacionit sipas nivelit të shqetësimit



së cilit merret informacioni rreth çështjeve mjedisore (Fig. 11), më saktësisht platformat e mediave sociale dhe faqet e lajmeve në internet, me respektivisht 61% dhe 60%. Për 50% të pjesëmarrësve në anketë, mjete kryesor përmes së cilit merret informacion rreth këtyre tematikave është televizioni, 43% faqet e internetit të organizatave mjedisore, 36% përmes bisedave me miq, familjar, kolegë, dhe 8% përmes gazetave/ revistave të shtypura. 6% shprehen se e marrin këtë informacion në mënyra të tjera si për shembull përmes insitucioneve kërkimore, universiteteve, artikujve shkencor, institucioneve publike, punës në terren, etj.

Analiza e burimeve të informacionit për

problematikat mjedisore sipas qarqeve të Shqipërisë e paraqitur në fig. 12 ofron një pamje të qartë rreth mënyrave se si qytetarët marrin informacion nga mediat dhe burimet e tjera në katër qytetet më të përfaqësuara në këtë vlerësim, Shkodër, Tiranë, Fier, Gjirokastrë.

Në Tiranë, duket se përqindja më e lartë e informacionit vjen nga platformat e mediave sociale (28%), faqet e lajmeve në internet (26%) dhe televizioni (17%). Kjo tregon një përdorim të përhapur të mjeteve digjitale dhe medias për informimin e publikut mbi çështjet mjedisore në kryeqytet. Nga ana tjetër, në Gjirokastrë, përqindja e përgjigjeve për përdorimin e

Figura 11. Cilat janë mjetet kryesore përmes së cilave merrni informacione rreth çështjeve mjedisore?





Figura 12. Burimi i informacionit sipas qarkut, në qarqet më të përfaqësuara



televizionit dhe mediave sociale është relativisht më e ulët, duke u përqëndruar më tepër tek televizioni. Ndërsa në Fier duket se shumica e pjesëmarrësve në anketë e marrin informacionin nga faqet e lajmeve në internet. Këto të dhëna shfaqin një ndryshim në preferencat e burimeve të informacionit.

Nga ana tjetër, qarqe të tjera si Kukësi dhe Vlora shfaqin një përdorim më të ulët të televizionit dhe mediave sociale, dhe ky trend mund të lidhet me faktin se pjesëmarrësit në anketë mund të kenë një akses më të vështirë në teknologji. Gjithashtu, është e rëndësishme theksuar se përmes bisedave me miqtë, familjarët dhe kolegët mbetet një burim i rëndësishëm i informacionit mjedisor në të gjithë qarqet, treguesi se shpërndarja e informacionit verbalisht mbetet një kanal i besueshëm komunikimi për shqiptarët.


Bazuar në këto gjetje, mund të sugjerohet një strategji ndërgjegjësuëse e kombinuar ndërmjet punës në terren, përdorimit të mediave televizive dhe online, duke përfshirë gjithashtu faqet e lajmeve në internet dhe platformat e mediave sociale. Zbatimi i kësaj strategjie do të përfshinte prodhimin e përmbajtjes informuese dhe ndërgjegjësuëse që përshtatet me preferencat e përdoruesve në secilin qark. Për të shtrirë ndikimin edhe më tej, organizatat mjedisore mund të shfrytëzojnë bisedat e drejtpërdrejta me ndjekës, miq, dhe kolegë për të përhapur mesazhet e tyre dhe për të inkurajuar diskutimet në komunitete. Gjetjet

tregojnë se ka një potencial të madh për të shfrytëzuar mediat sociale dhe internetin, kështu që një pjesë e rëndësishme e fushatave ndërgjegjësuëse duhet të përfshijnë përdorimin e platformave digjitale duke u fokusuar në krijimin e përmbajtjes që tërheq vëmendjen e audiencës së synuar. Pjesëmarrësit në anketë janë pyetur sa shpesh bisedojnë me miqtë, familjen ose kolegët për çështje të lidhura me qeverisjen dhe sigurinë mjedisore, apo çështje të tjera që lidhen me mjedisin (Fig. 13). 34% e pjesëmarrësve bisedon çdo javë me miqtë, familjen ose kolegët për këto çështje duke treguar një angazhim të konsiderueshëm ndaj diskutimeve të rregullta mbi temat që kanë lidhje me mjedisin. 28% deklaroi se bisedojnë çdo ditë, ndjekur nga 23% çdo muaj, 14% më rrallë se 1 herë në muaj dhe 1% kurrë.

Rezultatet tregojnë një spektër të gjerë të ndërgjegjësimit dhe përfshirjes së pjesëmarrësve në bisedat mbi çështje të lidhura me qeverisjen dhe sigurinë mjedisore, apo çështje të tjera që lidhen me mjedisin. Për të ndërmarrë veprime efektive për përmirësimin e ndërgjegjësimit dhe qeverisjes mjedisore, është e rëndësishme të kuptohen më mirë këto modele të ndërveprimit dhe të identifikohen sfidat ose mundësitë për përmirësim.

Përdorimi i internetit si burim kryesor tregon se shoqëria shqiptare po orientohet drejt botës virtuale. Nëse konsiderojmë se direkt pas internetit,

Figura 13. Sa shpesh bisedoni për qeverisjen dhe sigurinë mjedisore?



televizioni është burimi tjetër më i përdorur për të marr informacion, kuptojmë se e jona është një shoqëri mjaft e ndikuar nga media. Kjo shpërndarje është një sinjal i rëndësishëm për kujdesin që duhet treguar ndaj **edukimit të publikut për të kuptuar burimet e sakta dhe të besueshme të informacionit** dhe për t'i dalluar ato nga informacionet e rreme apo jo të sakta. Ajo që del në dukje është se bisedat e përditshme mbeten një mjet i rëndësishëm për shumë pjesëmarrës në marrjen dhe kalimin e informacioneve mjedisore. Kjo tregon për ndikimin e fuqishëm të bisedave (konceptit të njohur në anglisht si “word-of-mouth” dhe ndërveprimit social për këto tematika.

Rezultatet tregojnë se është e rëndësishme të përmirësohen strategjitë e komunikimit për të siguruar që informacioni rreth çështjeve mjedisore të jetë i arritshëm për një audiencë sa më të gjerë, si dhe që publiku të edukohet për të identifikuar saktë burimet e besueshme.

Rezultatet e paraqitura në fig 11 dhe 12 më sipër përforcohen më tej me përgjigjet e marra nga pyetja se cila është pengesa apo sfida kryesore me të cilën të anketuarit përballen kur kërkojnë informacion për çështjet mjedisore (Fig. 13). 62% e personave që përgjigjen deklarojnë se hasin vështirësi në gjetjen e burimeve të besueshme dhe 41% se marrin informacione të ndryshme për të njëjtën çështje nga burime të ndryshme. Sfida të tjera duket se janë gjuha teknike e përdorur (18% e të anketuarve), sasia shumë e madhe e informacionit (15%), qasja e kufizuar në internet ose media (13%), mungesa e kohës për të qëndruar të përditësuar (13%), mungesa e interesit dhe/ose motivimit (6%), apo edhe arsye të tjera (6%) si


informacioni i pakët nga media tradicionale, mungesa e lajmeve dedikuar çështjeve mjedisore, mungesa e burimeve zyrtare të informimit, etj.

Për t'u vënë në dukje janë përgjigjet e dy të anketuarve, një banues në Qarkun Fier dhe një në Qarkun Tiranë që thonë se mendojnë se informacioni që transmetohet në media është i manipuluar, ose që subjektet që ndotin më shumë janë ato që i korruptojnë këto media.

Siç tregojnë rezultatet, ekzistojnë një sërë pengesash dhe sfidash që pjesëmarrësit përballen kur kërkojnë informacion rreth çështjeve mjedisore. Për të përmirësuar njohuritë dhe ndërgjegjësimin, është e rëndësishme adresimi i këtyre pengesave përmes përmirësimeve në qasjen, transparencën e burimeve dhe përshtatshmërinë e gjuhës dhe formave të komunikimit, nevojën për filtra dhe burime të specializuara për të lehtësuar përpunimin dhe transmetimin e informacionit, etj.

Me synimin për të identifikuar çështjet më shqetësuese, publiku është pyetur se cilat janë problematikat më të mëdha mjedisore me të cilat komuniteti/ zona e tyre përballen (Fig. 14). Ndotja e ajrit, e ujërave dhe/ose e tokës është ajo që merr shumicën e përgjigjeve (83%), ndjekur nga transporti dhe menaxhimi i mbetjeve (65%), prerja, shkatërrimi dhe/ ose zjarrëvënia në pyje (42%), dëmtimi i habitateve dhe/ ose i llojeve të mbrojtura (31%), aktivitete që çojnë në lëshimin e substancave toksike (20%) dhe kryerja e aktiviteteve minerare (20%). Interesante është të theksojmë se 7% përgjigjet tjetër, duke listuar si problematika përmbytjet, përdorimi i mjeteve të

Figura 14. Cila është pengesa apo sfida kryesore me të cilën përballeti kur kërkoni informacion për çështjet mjedisore?



paligjshme të gjetisë, hedhjet e mbeturinave në vende jo të përshtatshme, ndërtimet e shumta që zvogëlojnë sipërfaqjet e gjelbërta, zvogëlimi i tokave për përdorim bujqësor, etj.

Identifikimi i qartë i problematikave në nivel lokal është një hap pozitiv në ndërgjegjësimin e publikut. Kjo njohje është e rëndësishme për të ndërmarrë hapa të mëtejshëm për të rritur dijen dhe ndërgjegjësimin për të veprime konkrete me synim përmirësimin e gjendjes mjedisore në komunitetet e tyre.

Analiza e problematikave mjedisore në katër qarqet më të përfaqësuara (fig. 15) shpalos disa gjetje kryesore rreth shqetësimeve të ndryshme mjedisore në nivel lokal. Në Tiranë, ndotja e ajrit, ujërave dhe

tokës shfaqet si një nga problemet më të mëdha, duke regjistruar përqindjen më të lartë (36%). Ndotja e ajrit gjithashtu shfaq ndjeshmëri në qarqet e tjera të mëdha si Fieri dhe Shkodra, ndërsa problematika të tjera si menaxhimi i mbetjeve dhe dëmtimi i habitatit janë shqetësime të përbashkëta që i shohim të shprehura në të gjitha qarqet.

Në qarqe të tilla si Lezha, Berati dhe Dibra, problemikat mjedisore përfshijnë ndotjen e ajrit dhe menaxhimin e mbetjeve. Problematika e transportit dhe menaxhimit të mbetjeve shfaqet si një shqetësim i përbashkët në të gjitha qarqet, por vlen të theksohet se Berati, Durrësi dhe Lezha raportojnë nivele më të larta të shqetësimit për këto sfida. Kjo mund të lidhet me mugesën e iniciativave vendore për menaxhimin e

Figura 15. Cilat janë problemikat më të mëdha mjedisore me të cilat komuniteti/ zona juaj përballet?





### Problematikat mjedisore sipas qarkut




Figura 16. Problematikat mjedisore sipas qarkut

mbetjeve dhe transportin e tyre për në vend-depozitime. Ky element thekson një nevojë të përgjithshme për përmirësimin e cilësisë së mjedisit në këto zona. Gjetjet tregojnë gjithashtu se disa problematika, si shkatërrimi/ zjarrvënja në pyje dhe aktivitete që çojnë në lëshimin e substancave toksike përbëjnë një shqetësim por në nivel më të ulët krahasuar me dy të parat.

Ky informacion na ndihmon të drejtojmë zhvillimin e materialeve informuese dhe të ndërgjegjësimit të përshtatura me problematikat dominuese në secilin qark. Organizatat mjedisore dhe autoritetet vendore, gjithashtu, mund të përqendrohen në adresimin e shqetësimeve specifike të secilit qark, duke përdorur kanale të ndryshme komunikimi për të arritur audiencën e synuar. Për shembull, në qytete si Tiranë, një fokus i veçantë mbi përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe menaxhimin e mbetjeve mund të jetë i nevojshëm, ndërsa në qytete më të vogla, një fokus mbi edukimin mbi praktikat mjedisore më të mira mund të jetë efektiv.

66% e të anketuarve shprehen se kanë marrë pjesë në një fushatë apo iniciativë ndërgjegjësimi të lidhur me çështje mjedisore, sigurinë dhe/ose qeverisjen mjedisore, ndërsa 34% thonë se nuk kanë marrë pjesë (Fig. 15). Rezultatet lënë të kuptosh se pjesëmarrja e komunitetit në fushata dhe iniciativa të ndërgjegjësimit të lidhura me çështje mjedisore, sigurinë dhe/ose qeverisjen mjedisore mirëpritet nga të anketuarit. Ky angazhim pozitiv shërben si një bazë e fortë për të

vazhduar dhe zgjeruar aktivitetet e ndërgjegjësimit për të adresuar çështjet mjedisore dhe promovuar sjellje të qëndrueshme dhe përgjegjshme ndaj mjedisit.

Të pyetur nëse kanë ndërvepruar me institucionet përgjegjëse për çështjet mjedisore (për shembull nëpërmjet pjesëmarrjes në konferenca, takime konsultuese, etj.), duke përfshirë tematikat e sigurisë dhe qeverisjes mjedisore, pjesa më e madhe prej 52% pjesëmarrësve kanë ndërvepruar me institucionet përgjegjëse për çështjet mjedisore më shumë se një herë, 18% një herë, dhe 30% asnjëherë (Fig. 16).

Nga të dhënat kuptojmë se është e rëndësishme që të vlerësohet përfshirja dhe ndërgjegjësimi i komunitetit duke zhvilluar strategji të ardhshme për të nxitur më tej pjesëmarrjen dhe ndërveprimin me institucionet përgjegjëse për çështjet mjedisore.

Pjesëmarrësve në anketë u është dhënë mundësia për të shprehur se cili është problemi më domethënës për ta në kuadër të kundërvajtjeve mjedisore. **Shumica prej 53% e pjesëmarrësve shprehet se mungesa e ndërgjegjësimit për problematikat mjedisore është problemi më domethënës sipas mendimit të tyre** (Fig. 17). Ky rezultat mund të tregojë një dëshirë dhe sugjerim për të rritur ndërgjegjësimin dhe informimin në lidhje me parandalimin e shkeljeve mjedisore dhe rritjen e mbrojtjes së mjedisit.

Figura 17. Pjesëmarrja në fushata ndërgjegjësimi





Figura 18. Ndërveprimi me institucione përgjegjëse



Një pjesë e rëndësishme e pjesëmarrësve (32%) shpreh shqetësim për mos-reagimin nga institucionet kur një problem raportohet. Një pjesë e pjesëmarrësve (9%) identifikon mungesën e dijeve rreth mënyrës së raportimit për problematikat mjedisore. Mungesa e informacionit mjedisor zë 4% të përgjigjeve, ndjekur nga 1% që përgjigjen tjetër. Në grupin e fundit, të anketuarit sugjerojnë se një problem mund të jetë se shoqëria nuk arrin të shikojë efektin afat-gjatë të dëmtimit të mjedisit, moszbatimi i ligjit, mosndëshkimi i personave që dëmtojnë mjedisin, paqartësi në kuadrin ligjor, etj.

Ky rezultat thekson rëndësinë e rritjes së ndërgjegjësimit dhe informimit në lidhje me çështjet mjedisore në komunitet për të përmirësuar përfshirjen dhe veprimet pozitive në drejtim të qeverisjes dhe sigurisë mjedisore. Në këtë drejtim ndihmon ekzistenca e mjeteve për sinjalizim dhe raportim të shkeljeve mjedisore, të tilla si Komisariati Dixhital i pajisur me

një hapësirë të dedikuar raportimit të këtyre shkeljeve. Megjithatë, siç tregohet në fig. 17, shfaqet nevoja për të adresuar mungesën e dijeve rreth mënyrës së raportimit për problematikat mjedisore së bashku me shqetësimin për mos-reagimin nga institucionet kur një problem raportohet. Këto rezultate janë tregues se nga njëra anë institucionet duhet të promovojnë më tepër këto mjete tek qytetarët, e nga ana tjetër, duhet të ndërmerren veprime konkrete kur një problem raportohet dhe publiku duhet të informohet për këto veprime.

79% e të anketuarve janë në dijeni se në Shqipëri ekziston një kuadër ligjor për monitorimin dhe dënimin e krimeve mjedisore, ndërsa 21% nuk janë në dijeni (Fig. 18). Ky rezultat mund të tregojë nevojën për të përmirësuar informacionin në veçanti në lidhje me ekzistencën dhe përmbajtjen e ligjeve dhe rregullave mjedisore në vend.

Figura 19. Problemet më domethënëse sipas të anketuarve





Figura 20. Dije për ekzistencën e kuadrit ligjor



Figura 21. Efektiviteti i qeverisjes dhe sigurisë



Siç tregohet në Tabelën 3 më poshtë, vërehen nivele të ndryshme të të kuptuarit të termave “qeverisje mjedisore”, “krim mjedisor” dhe “siguri mjedisore”. Bazuar në njohuritë ekzistuese të pjesëmarrësve në anketë në kohën e kryerjes së studimit, të aketuarit janë pyetur sa efektive ata mendojnë se është qeverisja mjedisore dhe zbatimi i politikave lidhur me sigurinë mjedisore në Shqipëri. Të dhënat tregojnë një ndarje të ndryshme të vlerësimeve nga pjesëmarrësit lidhur me efektivitetin e qeverisjes mjedisore dhe zbatimin e politikave për sigurinë mjedisore në Shqipëri (Fig. 19). 50% shprehet se qeverisja mjedisore dhe zbatimi i politikave lidhur me sigurinë mjedisore në Shqipëri janë shumë jo efektive apo jo efektive, 25% shprehen as jo efektive, as efektive, 19% disi efektive dhe vetëm 6% shumë efektive. Këto rezultate duhet të interpretohen në kuadrin e njohurive aktuale të publikut në momentin e plotësimit të pyetësorit. Si rrjedhim, perceptimi dhe opinioni i qytetarëve ndaj efektivitetit të qeverisjes mjedisore sugjerohet të vlerësohet sërish pas fushatës së ndërgjegjësimit për të patur të dhëna të krahasueshme dhe të plota që tregojnë jo vetëm ndryshimin e perceptimit, por edhe efektivitetin e fushatës.

Identifikimi dhe raportimi i dëmeve në mjedis janë hapa të rëndësishëm në zinxhirin e mbrojtjes së mjedisit dhe rritjes së ndëshkueshmërisë. Publiku është pyetur nëse ka përjetuar apo parë kryerjen e një dëmi në mjedisin e zonës ku ata jetojnë nga persona ose subjekte. 73% e pjesëmarrësve kanë raportuar se kanë përjetuar ose parë kryerjen e një dëmi në mjedisin e tyre nga persona ose subjekte (Fig. 20), ndërkohë që vetëm 43% përqind e tyre thonë se e kanë raportuar tek institucionet zyrtare (Fig. 21). Ndërsa, 35% thonë se e kanë raportuar këtë tek të njohurit e tyre dhe 22% nuk e kanë raportuar. Kjo mund të vijë si rezultat i mungesës

së besimit në efektivitetin e institucioneve zyrtare ose mungesën e informacionit për mënyrën e raportimit të rasteve të tilla.

Kur trajtojmë njohuritë dhe ndërgjegjësimin e publikut, është e rëndësishme të kuptojmë se rreth cilave çështje të lidhura me qeverisjen dhe sigurinë mjedisore ata do të donin të kishit më shumë informacion (Fig. 22). Tematikat që duket se kanë interes më të lartë janë ndotja e ajrit, e ujërave dhe/ ose e tokës (77%), transporti dhe menaxhimi i mbetjeve (58%), ndjekur nga prerja, shkatërrimi dhe/ ose zjarrëvënja në pyje (42%), dëmtimi i zonave të mbrojtura dhe/ ose i llojeve të mbrojtura (40%), aktivitete që çojnë në lëshimin e substancave toksike për njeriun dhe mjedisin (31%), dhe kryerja e aktiviteteve minerare (31%). Të anketuarit që janë përgjigjur se janë të interesuar për tematika të tjera (2%) sugjerojnë se duan më shumë informacion për të kuptuar çfarë përbën krim mjedisor, mënyrën si mund të raportojnë ndotjen e mjedisit dhe të ndjekin masat që merren për individët apo subjektet që ndotin, etj. Këto sugjerime i gjejmë të shprehura në Qarkun e Tiranës, si atë më të madh sa i takon numrit të popullsisë e rrjedhimisht, përfaqësimit në pyetësor. Edhe pse nevoja për informacion është e ndryshme në varësi të specifikave të zonave të ndryshme në Shqipëri, të dhënat e mbledhura mund të shërbejë si udhëzues për zhvillimin e fushatave të ndërgjegjësimit dhe informimit mjedisor, duke përmirësuar dijen dhe angazhimin e komunitetit në lidhje me çështjet mjedisore që janë të rëndësishme për ta.

Analiza e temave të preferuara nga pjesëmarrësit në lidhje me nevojën e tyre për më shumë informacion sipas qarqeve të banimit jep një pamje të detajuar rreth shqetësimeve mjedisore mbizotëruese në nivel lokal në Shqipëri. Në Tiranë, pjesa më e madhe e

Figura 22. Përjetimi i një dëmi mjedisor





Figura 23. Raportimi i dëmit mjedisor



pjesëmarrësve (31%) shprehen se janë të interesuar për të patur më shumë informacion rreth e ndotjes së ajrit, ujërave, dhe tokës, ndërkohë që transporti dhe menaxhimi i mbetjeve shfaqen si një temë tjetër e rëndësishme (22%). Ky rezultat tregon një gërshetim të shqetësimeve mjedisore për banorët e kryeqytetit, duke përfshirë shqetësimet e lidhura me cilësinë e ajrit dhe menaxhimin e mbetjeve urbane, por edhe dëmtimin e zonave të mbrojtura dhe llojeve të mbrojtura (18%), si dhe prerjen, shkatërrimin dhe zjarrëvënien në pyje (17%).

Për qytetet e tjera, tematika kryesore ndryshon në varësi të kontekstit lokal. Në Fier, ndotja e ajrit, ujit dhe tokës (12%) dhe menaxhimi i mbetjeve (7%) shfaqen si shqetësimet kryesore; ndërsa në qytetet e tjera, si Shkodra dhe Durrësi, tematika të tilla si dëmtimi i habitateve dhe kryerja e aktiviteteve minerare paraqiten si shqetësime domethënëse. Gjetjet tregojnë se ka nevojë për një përqendrim të veçantë në adresimin e shqetësimeve lokale dhe komunikimin e informacionit lidhur me to, duke përfshirë qytetarët në diskutimet për zgjidhjet dhe përmirësimin e situatës mjedisore.

Sugjerime për përdorimin e këtij informacioni gjatë fushatave ndërgjegjësuese përfshijnë organizimin e takimeve publike dhe eventeve gjithëpërfshirëse në secilin qark, ku tema e adresimit të ndotjes së ajrit dhe menaxhimit të mbetjeve të përqendrohet në Tiranë dhe tema të tjera, si dëmtimi i habitateve, shkatërrimi i pyjeve dhe aktivitetet minerare, të përfshihen në diskutimet lokale si për qytetarët e Tiranës, ashtu edhe ato të qarqeve të tjera. Përdorimi i mediave sociale dhe faqeve të internetit mund të jenë mjetet efektive për të përcjellë informacionin me synim angazhimit e komunitetit në dialog.

Me interes është të kuptohen dijet dhe njohuritë

e publikut rreth tre koncepte kryesore, “qeverisje mjedisore”, “siguri mjedisore” dhe “krim mjedisor”, jo vetëm nëse e kuptojnë plotësisht secilin nga konceptet, por edhe deri në çfarë niveli arrijnë dijet e tyre. Të gjithë të anketuarit janë pyetur për këto koncepte. Përgjigjet më të shpeshtja janë përmbledhur në tabelën 4.

Vlen për të theksuar se të kuptuarit e këtyre koncepteve ndryshon ndërmjet qarqeve, bashkive të ndryshme, si dhe zonave urbane nga ato rurale. Kjo mund të vijë si rezultat i problematikave të ndryshme specifike me të cilat secili komunitet përballet. Po ashtu, vërejmë se koncepti “siguri mjedisore” është ai më i vështirë për t’u kuptuar nga publiku (99.91% normë përgjigje), ndjekur nga “qeverisje mjedisore” (99.92% normë përgjigje) dhe “krim mjedisor” (99.94% normë përgjigje). Në këtë kontekst, është me rëndësi të qartësohen këto koncepte për publikun, si dhe ndryshimet ndërmjet këtyre koncepteve.

### 3.3. Çështjet gjinore dhe shkeljet mjedisore

Publikimi i përbashkët ndërmjet DCAF, OSCE/ODIHR dhe UN Women thotë se “përfshirja e perspektivës gjinore në sektorin e drejtësisë përmirëson sigurinë dhe sundimin e ligjit duke lehtësuar aksesin e barabartë në drejtësi. Ajo lufton mosndëshkimin e krimeve dhe përmirëson mbrojtjen kundër krimeve të tilla<sup>7</sup>.” Po ashtu, NATO pranon se “...në

7. DCAF, OSCE/ODIHR, UN Women (2019) “Justice and Gender”, in Gender and Security Toolkit. Geneva: DCAF, OSCE/ODIHR, UN Women, web <https://www.unwomen.org/sites/default/files/Headquarters/Attachments/Sections/Library/Publications/2019/GS-toolkit-Tool-04-en.pdf>

Figura 24. Rreth cilave çështje të lidhura me qeverisjen dhe sigurinë mjedisore do të donit të kishit më shumë informacion?





Figura 25. Tematikat që pjesëmarrësit kërkojnë më shumë informacion sipas qarqeve më të përfaqësara në anketë



*disa raste, gratë dhe vajzat, dhe grupet e marginalizuara do të ndikohen në mënyrë jo-proporcionale...*" nga ndikimet e mjedisit të jashtëm<sup>8</sup>.

Për të vlerësuar njohuritë dhe perceptimin e


publikut rreth lidhjes së çështjeve gjinore dhe shkeljeve mjedisore, ata u pyetën nëse besojnë se shkeljet mjedisore mund të kenë ndikime të ndryshme tek persona të ndryshëm bazuar në gjininë dhe rrethanat e tyre shoqërore. Shumica e pjesëmarrësve në anketë (71%) beson se shkeljet mjedisore kanë ndikime të ndryshme tek persona të ndryshëm, duke përfshirë aspektet e gjinisë dhe rrethanat shoqërore, ndërsa një grup më i vogël (29%) nuk beson se ka ndikime të

8. NATO. "The Secretary General's Report. Climate Change & Security Impact Assessment." NATO Web. 28 June 2022. [https://www.nato.int/nato\\_static\\_fl2014/assets/pdf/2022/6/pdf/280622-climate-impact-assessment.pdf](https://www.nato.int/nato_static_fl2014/assets/pdf/2022/6/pdf/280622-climate-impact-assessment.pdf)

Tabela 3. Çfarë kuptoni me “qeverisje mjedisore”, “siguri mjedisore” dhe “krim mjedisor”?

Qeverisje mjedisore	Siguri mjedisore	Krim mjedisor
Përcaktimi i rregulloreve strikte për aktivitetet që prekin mjedisin përfshirë hartimin dhe zbatimin e rregulloreve dhe standardeve të caktuara për aktivitetet që mund të kenë ndikim në mjedis.	Kontrolli i territorit duke përfshirë masat dhe veprimet për të kontrolluar dhe monitoruar territore të caktuara me qëllim mbrojtjen e tyre nga ndotja dhe rreziqet mjedisore.	Abuzim ekstrem mjedisor si përdorimi i jashtëzakonshëm dhe dëmtues i burimeve natyrore, që shkakton pasoja të rënda në ekosistemet dhe mjedisin.
Strukturat që llojnë për mirëqenien mjedisore të tilla si organizatat dhe strukturat që punojnë për të ndikuar në politikat dhe vendimet për mirëqenien mjedisore.	Aftësia për të kryer veprimtari që nuk sjellin rreziqe ose ndotje mjedisore, duke siguruar që aktivitetet njerëzore të jenë në përputhje me standardet dhe parimet mjedisore.	Çdo sjellje ose aktivitet që shkakton dëme, ndotje, apo shkatërrim të mjedisit dhe habitatit natyror.
Ligjet dhe rregulloret që janë pjesë e sistemit ligjor dhe kanë për qëllim të mbrojnë mjedisin dhe parandalimin e ndotjes së tij.	Vëmendja ndaj veprimeve dhe masave që ndërmarrin individët, komunitetet, dhe institucionet për të mbrojtur dhe ruajtur mjedisin.	Sjelljet dhe veprimet e individëve që shkaktojnë dëme të pakthyeshme në mjedis dhe që shpërfillin rregullat dhe kriteret për mbrojtjen e mjedisit.
Politikat mjedisore, kuadri ligjor për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.	Mbrojtje dhe menaxhim i qëndrueshëm i mjedisit për të përdorur burimeve natyrore në një mënyrë që nuk i cenon ato në afatgjatë.	Dëmtim dhe ndotje e natyrës përfshirë të gjitha burimet e saj.
Menaxhimi, mbrojtja dhe përmirësimi i mjedisit përmes veprimeve të qeverisë, organizatave ndërkombëtare, sektorit privat dhe shoqërisë civile.	Krijimi dhe mbajtja e një ambienti të sigurt për të jetuar.	Veprimtari të paligjshme: gjueti, prerje, zjarrvënie, etj., që përbëjnë vepra penale, bazuar në kushtetutë, ligje kombëtare apo ndërkombëtare.
Masat dhe politikat për të përmirësuar cilësinë e ajrit, ujrave dhe tokës, si dhe për të parandaluar ndotjen dhe degradimin e tyre.	Sigurimin e një sasive të mjaftueshme të vegetacionit dhe bimësisë në mjedis.	Shkatërrim i mjedisit.
Strategjitë dhe politikat që kanë për qëllim ruajtjen e sipërfaqeve të tokës dhe ujit, duke përfshirë planifikimin e zhvillimit urban dhe rural.	Monitorimi dhe vlerësimi i rregullt të mjedisit, duke përfshirë pjesëmarrjen aktive të komunitetit dhe autoriteteve në këtë proces.	Dëmet në mjedis që nuk mund të kthehen prapa, duke shkakuar pasoja të vazhdueshme dhe të pariparueshme.
Politikat dhe veprimet që kanë si qëllim të sigurojnë që mjedisi ku jetojmë të jetë i pastër, i sigurtë, dhe i shëndetshëm.	Krijimi i kushteve mjedisore të përshtatshme për jetë të shëndetshme.	Shkatërrimi i pyjeve, hedhja e mbeturinave në ujërat natyrore si lumenj, liqene, dhe dete.
Mirëmenaxhimi mjedisor nga agjenci të specializuara.	Përpjekjet dhe masat për të shmangur çdo formë të dëmtimit ose ndotjes së mjedisit.	Ndërhyrja në mjedis pa miratimin e komunitetit dhe aktorëve lokal.
Organizimi dhe monitorimi i aktiviteteve industriale, trajtimi i mbeturinave, dhe planifikimi i ndërhyrjeve në mjedis për të minimizuar ndikimin negativ.	Krijimi dhe mbrojtja e zonave të caktuara që janë të mbrojtura nga ligje dhe rregullore specifike për të ruajtur vlerat mjedisore.	Shkatërrim, ndotje, shfrytëzim pa kriter i mjedisit.
Zbatimi i ligjeve dhe rregulloreve për parandalimin dhe kontrollin e ndotjes së mjedisit dhe dënimin e atyre që shkelin këto rregulla.	Pasurimi dhe ruajtja e mjedisit natyror duke përdorur strategji dhe praktika të qëndrueshme.	Zjarret e pakontrolluara, minierat, dhe shfrytëzimi i pa kontrolluar i bimësisë dhe faunës në mënyrë të dëmshme.
Përfshin përpjekjet për të ruajtur dhe mbrojtur zonat natyrore dhe të mbrojtura, duke përfshirë habitatet natyrore dhe ekosistemet.	Siguria mjedisore synon ruajtjen e ekosistemeve, trajtimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe ndërgjegjësimin e njerëzve për rëndësinë e mjedisit.	Dëmtimi dhe shfrytëzimi pa kriter i resurseve mjedisore.

Figura 26. Ndikimi i shkeljeve mjedisore




ndryshme tek persona të ndryshëm (Fig. 24).

Pjesëmarrësve në anketë u është kërkuar të shprehin opinionin e tyre rreth cilëve grupe ata mendojnë se preken në mënyrë më të theksuar nga shkeljet mjedisore (Fig. 25). Shumica prej 79% vlerëson se të gjitha grupet preken në mënyrë të njëjtë nga shkeljet apo krimet mjedisore, ndjekur nga 18% që shprehen se gratë dhe vajzat preken në mënyrë më të theksuar dhe 3% shprehen burrat dhe djemtë. Në mbështetje të rezultateve të paraqitura në fig. 24, komentet që janë mbledhur nga pjesëmarrësit gjatë anketimit ballë-për-ballë për këtë pyetje ndihmojnë për të kuptuar qasjen e tyre. Sa i takon ndikimit të shkeljeve mjedisore në grupe të ndryshme shoqërore apo gjinore, të kuptuarit e pjesëmarrësve në anketë shkon më tepër në drejtim të krijimit të pabarazisë ndaj gupeve të ndryshme shoqërore (për shëmbull, të moshuar, persona me aftësi të vecanta, etj.), e më pak në drejtim të pabarazive gjinore. Vlen të përmendet se perceptimi i grave për ndikimin e gjinisë së tyre nga shkeljet mjedisore është i ndryshëm nga ai i burrave. Prej pjesëmarrësve në anketë që janë përgjigjur se më të prekur janë gratë dhe vajzat, 83% janë gra dhe 17% janë burra.

Po ashtu, siç tregohet në figurën 26, 41% e pjesëmarrësve në anketë të cilët janë përgjigjur se kanë përjetuar raste të shkeljeve mjedisore (referohu fig. 20), janë gra. Kjo mbështet edhe më tej argumentin se perceptimi dhe përjetimi i dëmeve në mjedis ndryshon ndërmjet gjinive të ndryshme.

Duke u fokusuar tek të dhënat e paraqitura në fig. 25, ku rezultatet tregojnë se shumica shprehet se të gjitha grupet preken në mënyrë të njëjtë, kjo mund të

Figura 27. Grupet që preken më shumë



vijë për shkak të përvojës së tyre dhe të kuptuarit e ndikimeve të shkeljeve mjedisore në gjinitë e ndryshme. Si rrjedhim, sugjerohet të drejtohet një fokus i veçantë ndërgjegjësues për mënyrën se si shkeljet mjedisore prekin grupe të ndryshme jo vetëm sociale, por edhe gjinore, në mënyrë të ndryshme.


Një nga pasojat e shkeljeve mjedisore mund të jetë krijimi i pabarazisë gjinore si qasja e kufizuar e grave në burime natyrore, udhëtime më të gjata për të siguruar ushqim dhe ujë, rritje e rrezikut për gratë që punojnë në bujqësi/ blegtori, etj. Megjithatë fokusi i pjesëmarrësve në anketë janë pasojat e shkeljeve mjedisore tek grupe të ndryshme sociale, vihet re një pranim se aktivitete të tilla si ato të listura që tradicionalisht mbulohej nga gruaja në familje/ shoqëri mund të shkaktojnë pabarazi. Shumica e pjesëmarrësve (58%) shprehen se nuk kanë hasur në raste të tilla të pabarazisë gjinore për shkak të shkeljeve mjedisore, e megjithatë një numër i konsiderueshëm i pjesëmarrësve (42%) pranojnë se kanë hasur në raste kur shkeljet mjedisore kanë krijuar pabarazi gjinore, (Fig. 27).

Perceptimi i pjesëmarrësve në anketë shihet më i diversifikuar kur pyeten nëse mendojnë se zakonet, kultura dhe vlerat e shoqërisë ndikojnë në rritjen e ndjesisë së pasigurisë dhe diskriminimit ndaj grave për shkak të shkeljeve mjedisore. 36% e të anketuarve thonë se zakonet, kultura dhe vlerat e shoqërisë kanë ndikim në rritjen e ndjesisë së pasigurisë dhe diskriminimit ndaj grave për shkak të shkeljeve mjedisore, ndjekur nga 34% që shprehen se kanë shumë ndikim, 19% shprehen asnjëanës, 7% thonë se nuk kanë ndikim dhe 4% mendojnë se nuk kanë fare ndikim (Fig. 28).

Siç tregohet nga rezultatet e paraqitura në fig. 24,



Figura 28. Raste të përjetimit të shkeljeve mjedisore sipas gjinisë



25 dhe 27, pjesëmarrësit në anketë pranojnë se shkeljet mjedisore ndikojnë në mënyrë më të theksuar gratë. Megjithatë, kur vendosen përballë ndikimit të shkeljeve mjedisore në grupe të ndryshme gjinore apo grupe të ndryshme sociale, pesha më e madhe e perceptimit të tyre drejtohet tek ndikimi më i theksuar në varësi të grupeve sociale.

Këto rezultate tregojnë se duhet më shumë punë për të ndihmuar publikun në identifikimin dhe të kuptuarit e ndikimit të shkeljeve mjedisore në gjinitë e ndryshme për të zvogëluar pabarazitë në të ardhmen. Gjithashtu, të dhënat tregojnë nevojën për të informuar më mirë publikun rreth lidhjeve që ekzistojnë ndërmjet mënyrës se si zakonet, kultura dhe vlerat e shoqërisë ndikojnë në rritjen e ndjesisë së pasigurisë dhe diskriminimit ndaj grave për shkak të shkeljeve mjedisore.

Po ashtu, një pyetje tjetër e cila gjen përgjigje heterogjene është se a duhet që politikatat mjedisore dhe ndëshkimet ndaj shkeljeve mjedisore të marrin parasysh gjithashtu qasjen gjinore për të siguruar drejtësi të barabartë për të gjithë (Fig. 29). 35% shprehen se janë shumë dakord dhe 25% shprehen se janë dakord, ndërsa 23% shprehen se janë neutral. Vetëm 8% e pjesëmarrësve thonë se nuk janë dakord dhe 6% nuk janë aspak dakord.

Rezultatet tregojnë ndarje në qëndrimet ndaj nevojës së marrjes parasysh të qasjes gjinore në politikatat mjedisore dhe ndëshkimet për kundërvajtjet mjedisore. Megjithatë, një shumicë e pjesëmarrësve shprehen përkrahëse ndaj kësaj ideje, duke theksuar rëndësinë e drejtësisë të barabartë dhe ndalimit të diskriminimit gjinor në këtë kontekst.

Figura 29. Shkeljet mjedisore shkaktojnë pabarazi




Figura 30. Ndikimi i normave shoqërore dhe kulturore





Figura 31. Politikat dhe ndëshkimet të marrin parasysh qasjen gjinore



Në vijim, pyetësi i anketës mundësoi edhe pyetje të hapura për të mbledhur perceptimin dhe mendimin e publikut. Duket se bashkëpunimi midis organizatave jo-fitimprurëse të fokusuara në çështjet gjinore dhe autoriteteve publike shihet si shumë i rëndësishëm për integrimin e qasjes gjinore në trajtimin e shkeljeve dhe krimeve mjedisore. Të pyetur se sa e rëndësishme është që organizatat jo-fitimprurëse me fokus çështjet gjinore dhe autoritetet publike të bashkëpunojnë kur trajtojnë shkeljet mjedisore, 7% e pjesëmarrësve janë përgjigjur “nuk e di” ose nuk kanë dhënë një koment, ndërkohë që 93% kanë dhënë mendimin e tyre. Në tabelën nr. 5 paraqiten shtatë fushat në të cilat publiku mendon se roli i këtyre organizatave është më i rëndësishëm, së bashku me sugjerime për mënyrën se si aktivitetet e tyre mund të kenë më shumë ndikim.

Publiku është pyetur gjithashtu për mendimin e tyre se si institucionet arsimore dhe kurrikulat që përdoren prej tyre mund të ndikojnë për të përfshirë çështjet gjinore në ndërgjegjësimin mjedisor. Me normë përgjigje 88%, në tabelën nr. 6 paraqiten disa nga tematikat që janë përmendur më shpesh në përgjigjet e publikut, si dhe aktivitetet e sugjeruara për të rritur ndikimin.

Siç shihet, roli i institucioneve arsimore është i rëndësishëm, jo vetëm për edukimin e nxënësve, por edhe të prindërve. Nga ana tjetër, edukimi nuk ndalon vetëm në kurrikulat e arsimit formal, por edhe ndikimin përmes aktiviteteve jashtëshkollore dhe sociale.

### 3.4. Roli i korrupsionit në shkeljet mjedisore

Korrupsioni është parë se ndikon në lehtësimin e kryerjes së krimeve mjedisore<sup>9</sup>. Në këtë nën-çështje kërkohet të studiohen dijet, ndërgjegjësimi dhe eksperiencia e publikut ndaj lidhjeve që ka korrupsioni me shkeljet mjedisore.

Të pyetur nëse besojnë se korrupsioni në institucionet publike ndikon në shkeljet mjedisore, 94% besojnë se ka ndikim, përkundrajt 6% që mendojnë se nuk ka ndikim (Fig. 30). Ky rezultat paraqet këndvështrimin e qytetareve për mënyrën se si ata e perceptojnë rolin e korrupsionit në ruajtjen e mjedisit dhe parandalimin e krimeve mjedisore.

Në vijim, publiku pyetet se a kanë dijeni për raste kur korrupsioni është i lidhur me aktivitete të tilla si prerja e pyjeve, zjarrvënja, hedhja e mbeturinave, ndotja e ajrit, etj. Shumica e pjesëmarrësve (46%) ka dëgjuar për raste të tilla nga miqtë, familjarët ose media dhe një pjesë e konsiderueshme (34%) deklaroi se janë në dijeni për raste të tilla. Një pjesë më e vogël e pjesëmarrësve (20%) nuk është në dijeni për raste të tilla të lidhura me korrupsion në aktivitetet mjedisore (Fig. 31).

Analiza e të dhënave tregon se perceptimi i qytetareve në lidhje me rastet e korrupsionit ndryshon nëpër qarqe të ndryshme të Shqipërisë (Fig. 32). Për shembull, një pjesë e konsiderueshme e përgjigjeve vjen nga banorët e Tiranës, ku 10% e tyre konfirmojnë se kanë përjetuar ose dijnë për raste të korrupsionit në zonën e tyre të banimit. Në anën tjetër, qytetarët e qyteteve si Berati, Dibra, Durrësi dhe Lezha raportojnë një përjetim të ulët të rasteve të tilla, secila me 1%.

Një aspekt interesant është fakti se 23% e pjesëmarrësve banues në Qarkun Tiranë përgjigjen se kanë dëgjuar për raste të korrupsionit përmes miqve, familjarëve, ose medias, duke treguar për një ndikim të fuqishëm të informacionit të përhapur nga kanale jozyrtare.

Nëse analizojmë përgjigjet e atyre që nuk kanë dijeni për raste të korrupsionit, pjesëmarrësit në anketë nga Qarku i Fierit (8%) dhe Tiranës (5%) janë ata që më se shumti shprehen se nuk kanë dijeni për raste të korrupsionit.

9. Thompson, S.T. The Convergence of Environmental Crime and Corruption: An Operational Typology. *Int Criminol* 3, 133-148 (2023). <https://doi.org/10.1007/s43576-023-00093-2>

Tabela 4. Sa e rëndësishme mendoni se është që organizatat jo-fitimprurëse me fokus çështjet gjinore dhe autoritetet publike të bashkëpunojnë kur trajtojnë shkeljet/ krimet mjedisore?

Nr.	Fusha me rëndësi	Sugjerime për aktivitete
1	Bashkëpunimi në nivel qendror	<ul style="list-style-type: none"> <li>a. Të sjellët e perspektivave të ndryshme dhe ndërgjegjësimi i publikut</li> <li>b. Fuqizimi i zërit të grave dhe vajzave në trajtimin e shkeljeve mjedisore</li> <li>c. Përgatitja e masave parandaluese dhe monitorimi i zbatimit të ligjit</li> </ul>
2	Bashkëpunimi në nivel lokal	<ul style="list-style-type: none"> <li>a. Fuqizimi i zërit të grupeve të ndryshme për adresimin e nevojave të tyre</li> <li>b. Të mbuluarit e çështjeve që sektori publik e privat nuk mund të trajtojë</li> <li>c. Të ofrojnë kapacitetet dhe burimet shtesë në hetimet dhe monitorimin e shkeljeve mjedisore</li> </ul>
3	Përcaktimi i politikave dhe legjislacionit	<ul style="list-style-type: none"> <li>a. Të ndihmojnë në zhvillimin dhe përmirësimin e legjislacionit mjedisor me një perspektivë gjinore</li> </ul>
4	Plotësimi i ndërsjelltë i qëllimeve dhe ekspertizave	<ul style="list-style-type: none"> <li>a. Të sjellët e ekspertizës së specializuar për zgjidhjen e shkeljeve mjedisore në kontekstin e barazisë gjinore</li> </ul>
5	Ndryshimi i mentalitetit dhe ndërgjegjësimi	<ul style="list-style-type: none"> <li>a. Rritja e ndërgjegjësimit për lidhjen midis shkeljeve mjedisore dhe impaktin e tyre tek gratë dhe vajzat</li> <li>b. Nxitja e përkushtimit të autoriteteve publike</li> </ul>
6	Lobimi dhe ndikimi në politika	<ul style="list-style-type: none"> <li>a. Bashkëpunimi me autoritetet publike për të ndihmuar në krijimin e mjedisit ligjor dhe politik</li> </ul>
7	Forcimi i zbatimit të ligjit	<ul style="list-style-type: none"> <li>a. Të ndihmojnë në identifikimin e shkeljeve mjedisore me ndikim të ndryshëm tek grupe të ndryshme</li> <li>b. Të rritin ndërgjegjësimin e autoriteteve publike rreth ndikimit të shkeljeve mjedisore tek grupe të ndryshme</li> </ul>


Tabela 5. Si mendoni se mund të ndikojnë institucionet arsimore dhe kurrikulat që përdoren prej tyre për të përfshirë çështjet gjinore në ndërgjegjësimin mjedisor?

Nr.	Tematika	Aktivitetet e propozuara
1	Kurrikula gjithëpërfshirëse me perspektivë gjinore	<ul style="list-style-type: none"> <li>a. Përfshirja e perspektivave gjinore në kurrikula</li> <li>b. Adresimi i roleve dhe ndikimi i ndryshëm i çështjeve mjedisore tek gjinitë e ndryshme</li> <li>c. Thjeshtësimi në mësimdhënie</li> </ul>
2	Përfaqësimi dhe pjesëmarrja gjinore në fushën mjedisore	<ul style="list-style-type: none"> <li>a. Rritja e përfaqësimit të grave në modulet mjedisore dhe në pozicionet drejtuese</li> <li>b. Përfshirja e roleve gjinore në edukimin mjedisor</li> </ul>
3	Të menduarit kritik dhe diskutimet	<ul style="list-style-type: none"> <li>a. Inkurajimi i të menduarit kritik dhe diskutimit të hapur për lidhjen ndërmjet çështjeve mjedisore dhe atyre gjinore</li> <li>b. Ndikimi në rritjen e ndërgjegjësimit</li> </ul>
4	Aktivitete jashtëshkollore dhe klubet studentore	<ul style="list-style-type: none"> <li>a. Mbështetja e klubeve dhe organizatave studentore</li> <li>b. Pjesëmarrja dhe ndërgjegjësimi i nxënësve</li> </ul>
5	Partneritetet dhe bashkëpunimet me organizata me fokus gjinor dhe mjedisor	<ul style="list-style-type: none"> <li>a. Bashkëpunimi me organizata dhe ekspertë që fokusohen në çështjet gjinore dhe mjedisore</li> <li>b. Angazhimi me komunitetet lokale në projekte mjedisore dhe ato të lidhura me gjininë</li> </ul>
6	Politikat e përgjegjshme ndaj gjinive	<ul style="list-style-type: none"> <li>a. Zbatimi i politikave të përgjegjshme ndaj gjinive brenda institucioneve arsimore</li> </ul>
7	Ndërgjegjësimi i prindërve	<ul style="list-style-type: none"> <li>a. Angazhimi i prindërve si një burim i rëndësishëm i ndërgjegjësimit në këto fusha</li> </ul>

Figura 32. A ndikon korrupsioni shkeljet mjedisore?



Figura 33. Dijeni të rasteve të korrupsionit



Kjo analizë e ndarjes së perceptimeve sipas qarqeve ofron një pamje të detajuar të ndryshimeve në perceptimin dhe informacionin e qytetarëve mbi fenomenin e korrupsionit në nivele lokale. Për politikën kundër korrupsionit, këto të dhëna mund të shërbejnë si bazë për përmirësimin e veprimeve dhe ndërmarrjen e masa të veçanta për secilën zonë.

Interesante është të përmendim se **76% e të anketuarve shprehen se kanë hasur në raste kur zbatimi i dobët i legjislacionit mjedisor vjen për shkak të korrupsionit**, përkundrajt 24% që thonë se nuk kanë hasur raste të tilla (Fig. 33).

Rezultatet tregojnë për një shumicë të qartë të pjesëmarrësve të cilët janë të bindur se korrupsioni ka ndikuar në zbatimin e dobët të legjislacionit mjedisor. Ky rezultat vë në dukje një shqetësim të theksuar në lidhje

me ndikimin negativ të korrupsionit në integritetin e sistemit të drejtësisë dhe zbatimin e ligjeve të lidhura me çështjet mjedisore.

Siç tregohet në figurën 34, **90% e të anketuarve mendojnë se adresimi i korrupsionit është thelbësor për të përmirësuar qeverisjen mjedisore dhe për të parandaluar shkeljet mjedisore.**

Rezultatet tregojnë një qëndrim shumë të fortë nga pjesëmarrësit në lidhje me rëndësinë e adresimit të korrupsionit për të përmirësuar qeverisjen mjedisore dhe parandalimin e shkeljeve mjedisore. Ky qëndrim shpreh një ndërgjegjësim të fortë për rolin kritik të integritetit të institucioneve në mbrojtjen e mjedisit dhe parandalimin e shkeljeve mjedisore.

Ndër agjencitë ligj-zbatuese në luftën ndaj

Figura 34. Dijeni të rasteve të korrupsionit sipas qarkut të banimit, në qarqet më të përfaqësuara





Figura 35. Zbatimi i ligjit dhe korrupsioni




korrupsionit në shkeljet apo krimet mjedisore përmendim Bashkitë, Inspektoriatin Mjedisor, Policinë, Prokurorinë, Gjykatat, etj. Publiku është kërkuar të shpreh kënaqësinë ndaj këtyre agjencive ligj-zbatuese (Fig. 35). Shumica më e madhe e pjesëmarrësve (29%) shprehet shumë e pakënaqur me rolin e agjencive ligj-zbatuese në luftën ndaj korrupsionit në shkeljet/krimet mjedisore dhe një pjesë e mirë (17%) shprehet disi e pakënaqur. Një pjesë e konsiderueshme (26%) nuk ka një qëndrim të qartë për rolin e agjencive ligj-zbatuese duke u shprehur asnjëanës. Pjesa e publikut që shprehen disi të kënaqur janë 21% dhe pjesa më e vogël prej 8% janë ata që shprehen shumë të kënaqur.

Rezultatet tregojnë një nivel mjaft të lartë të pakënaqësisë në lidhje me rolin e agjencive ligj-zbatuese në luftën ndaj korrupsionit në shkeljet mjedisore. Po ashtu, fakti se një pjesë e rëndësishme e pjesëmarrësve në anketë nuk kanë një qëndrim për rolin e agjencive ligj-zbatuese mund të jetë tregues për mungesë të informimit të publikimit mbi rolin e agjencive ligj-zbatuese ose/ dhe se si mund të raportojnë rastet e korrupsionit të lidhura me shkeljet mjedisore. Kjo mund të paraqesë një sfidë për institucionet për të rritur efikasitetin dhe besueshmërinë në trajtimin e shkeljeve mjedisore në kontekstin e korrupsionit.

Krahas punës së institucioneve publike, roli i organizatave jo-fitimprurëse është i rëndësishëm në adresimin e problematikave mjedisore. Të pyetur se a njohin organizata që punojnë në luftën ndaj korrupsionit të lidhur me shkeljet ose krimet mjedisore apo mirë-qeverisjen mjedisore, pjesa më e madhe prej 59% shprehen se nuk njohin, ndërsa 41% shprehen se njohin organizata të tilla (Fig. 36).

Figura 36. Adresimi i korrupsionit për të ulur nr e shkeljeve mjedisore




Të dhënat e mbledhura tregojnë se një pjesë e konsiderueshme e pjesëmarrësve nuk njohin organizata të veçanta që janë të përfshira në luftën ndaj korrupsionit në lidhje me shkeljet mjedisore ose mirë-qeverisjen mjedisore. Kjo mund të sugjerojë nevojën për më shumë ndërgjegjësim dhe informacion në lidhje me rolin e organizatave në këtë fushë dhe si ato mund të kontribuojnë në adresimin e sfidave të korrupsionit në identifikimin, raportimin dhe ndëshkimin e kundërvajtjeve mjedisore. Nga ana tjetër, kjo gjetje mund të tregoj mungësen e trajtimit të korrupsionit të lidhur me shkeljet mjedisore prej organizatave jo-fitimprurëse. Këto organizata mund të adresojnë këtë boshllëk duke zgjeruar programet, veprimtaritë dhe ndërhyrjet e tyre në këtë fushë.

Ryshfeti përfshin dhënien ose marrjen e diçkaje me vlerë për të ndikuar në veprimet ose vendimet e një personi, shpesh në kundërshtim me ligjin ose standardet etike. Korrupsioni përfshin përdorimin e pushtetit ose autoritetit për përfitime personale, shpesh përmes mjeteve të paligjshme ose joetike<sup>10</sup>.

Rezultatet e pyetjes nëse pjesëmarrësit në anketë janë në dijeni për raste kur individë ose biznese kanë përdorur ryshfet për t'iu shmangur rregullave ose ndëshkimeve mjedisore tregojnë një ndarje pothuajse të barabartë (51% janë përgjigjur "jo" dhe 49% janë përgjigjur "po") (Fig. 37). Kjo mund të ndërlikojë përpjekjet për zbatimin e rregullave dhe legjislacionit mjedisor dhe thekson rëndësinë e monitorimit dhe

10. Financial Crime Academy, web: <https://financialcrimeacademy.org/bribery-and-corruption-3/#:~:text=Bribery%20involves%20giving%20or%20receiving,through%20illegal%20or%20unethical%20means.>

Figura 37. Sa të kënaqur jeni me rolin e agjencive ligj-zbatuese në luftën ndaj korrupsionit në shkeljet/ krimet mjedisore (Bashkia, Inspektorati Mjedisor, Policia, Prokuroria, Gjykata)?



raportimit të rasteve të tilla për të adresuar këto shqetësime.

Po ashtu, veprimtari të tilla si ryshfeti dhe/ose korrupsioni aktiv për t'iu shmangur ndëshkimeve mjedisore, mund të rezultojë në rritje të sjelljeve abuzive ndaj mjedisit, të cilat si rrjedhim mund të lehtësojnë shfrytëzimin e burimeve natyrore apo kërcënimin e shëndetit public. Kjo krijon një spirale ku korrupsioni favorizon shfrytëzimin e jashtëligjshëm të mjedisit, e në vijim kjo e fundit sjell më shumë korrupsion, e kështu me radhë. Si rrjedhim, më shumë punë është e nevojshme për të rritur njohuritë e publikut në identifikimin dhe raportimin e rasteve të tilla.

Një e dhënë shqetësuese është se prej personave të cilët deklarojnë se janë në dijeni për raste kur individë ose biznese kanë përdorur ryshfet për t'iu shmangur rregullave ose ndëshkimeve mjedisore, 79% deklarojnë se nuk e kanë raportur këtë gjë (Fig. 38).

Shumica e pjesëmarrësve që janë në dijeni për rastet e përdorimit të ryshfetit nuk kanë raportuar këto shkelje. Kjo mund të tregojë për mungesë dijeve rreth mënyrës së raportimit, mungesës së besimit në efektshmërinë e raportimit të këtyre rasteve, ose mungesës së një sistemi të besueshëm për kërkimin dhe zbardhjen e rasteve të korrupsionit mjedisor.

Në veçanti, mungesa e besimit në efektshmërinë e

Figura 38. A njihni OJF që luftojnë krimin mjedisor?




Figura 39. Adresimi i korrupsionit për të ulur nr e shkeljeve mjedisore





Figura 40. A e keni raportur rastin e ryshfetit?



raportimit të këtyre rasteve mund të jetë një shpjegim pse pjesëmarrësit në anketë shprehen shumë të pakënaqur ose të pakënaqur me rolin e agjencive ligj-zbatuese në luftën ndaj korrupsionit në shkeljet mjedisore (referohu fig. 35).

Në vijim, publiku është pyetur për mendimin e tyre lidhur me sa i rëndësishëm është bashkëpunimi midis institucioneve dhe publikut në adresimin e korrupsionit lidhur me shkeljet dhe krimet mjedisore. Siç tregohet në figurën 39, shumica absolute e pjesëmarrësve (86%) vlerësojnë se bashkëpunimi midis institucioneve dhe publikut është shumë i rëndësishëm në adresimin e korrupsionit lidhur me shkeljet dhe krimet mjedisore. 8% e publikut shprehen se është disi i rëndësishëm, 4% janë neutral dhe 1% shprehen aspak i rëndësishëm.

Pjesëmarrësit në anketë shprehen pozitiv për rëndësinë e bashkëpunimit me institucionet për të ulur ndikimin e korrupsionit në shkeljet mjedisore. E megjithatë, kjo varet gjithashtu nga faktorë të tjerë, të tillë si mungesa e kënaqësisë që qytetarët shprehin ndaj agjencive ligj-zbatuese (46% - referohu fig. 35) dhe vullnetit të qytetarëve për të raportuar rastet e ryshfeteve (79% - referohu fig. 38).

Si rrjedhim, nevojiten strategji të mirëfillta për të nxitur pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në këtë drejtim, të cilat në afat-mesëm dhe afat-gjatë do të rrisin qasjen dhe do të lehtësojnë angazhimin e tyre në identifikim dhe raportim të këtyre rasteve. Po ashtu, kjo e dhënë mund të tregojë për nevojën e një përfshirjeje më të gjerë dhe të koordinuar në këtë fushë për të arritur rezultate më të mira dhe për të adresuar sfidat mjedisore në mënyrë efektive.

Në vijim, publiku është kërkuar të shpreh mendimin e tyre lidhur me rolin që duhet të luajnë institucionet publike në promovimin e qeverisjes mjedisore dhe se si ato mund të angazhohen në mënyrë më efektive me publikun në proceset vendimmarrëse. Këto duken se janë tematika shumë të ndjeshme për qytetarët, duke qenë se edhe pse kjo pyetje ishte jo e detyrueshme, norma e përgjigjes është 78%. Tabela nr. 6 jep listën me tematikat e përmendura më shpesh nga publiku në nivel kombëtar, së bashku me veprimtaritë e propozuara që mund të ndërmerren.

Siç del qartë nga përgjigjet e publikut, qytetarët kërkojnë më shumë bashkëpunim me institucionet publike, private dhe organizatat jo-fitimprurëse, më shumë edukim dhe ndërgjegjësim për mënyrën se si ata mund të angazhohen, dhe më shumë monitorim dhe llogaridhënie nga institucionet publike.

### 3.5. Sugjerime për përmirësim

Me qëllim adresimin e shqetësimeve, boshllëqet në njohuri, apo keqinterpetimet, publiku është kërkuar të sugjerojë përmirësime në fusha të ndryshme.


Shumica absolute prej 97% e pjesëmarrësve në anketë mendojnë se publiku luan një rol të rëndësishëm në qeverisjen dhe sigurinë e mjedisit (Fig. 40), ndërkohë që vetëm 3% mendojnë se publiku nuk luan rol në këtë proces.

Kjo mbështetje e fortë për idenë se publiku dhe qytetarët kanë një rol të rëndësishëm në qeverisjen dhe sigurinë e mjedisit mund të reflektojë nevojën për përfshirje të qytetarëve në proceset vendimmarrëse dhe ndërgjegjësimin e tyre në lidhje me çështjet mjedisore për të siguruar një përmirësim efektiv të situatës mjedisore dhe të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm të mjedisit.

Në po të njëjtën linjë, pjesa më e madhe prej 90% e të anketuarve mendojnë se kryerja e fushatave të ndërgjegjësimit dhe nismave për edukim për qeverisjen dhe sigurinë mjedisore do të ndikojnë pozitivisht në angazhimin e publikut në përpjekjet për mbrojtjen e mjedisit dhe raportimin e dëmeve ose krimeve në mjedis (Fig. 41). Vërejmë së 90% e të anketuarve shprehen se janë të sigurt për këtë dhe vetëm 1% shprehen se nuk mendojnë se kryerja e këtyre fushatave do të ketë një ndikim pozitiv.



Figura 41. Sa i rëndësishëm është bashkëpunimi midis institucioneve dhe publikut në adresimin e korrupsionit lidhur me shkeljet/ krimet mjedisore?



Rezultatet tregojnë një mbështetje të fortë për idenë se fushatat e ndërgjegjësimit dhe iniciativat për edukim mjedisor mund të ndikojnë pozitivisht në angazhimin e publikut për mbrojtjen e mjedisit dhe raportimin e dëmeve apo krimeve në mjedis. Ky është një tregues i rëndësishëm për nevojën dhe rëndësinë e kryerjes së iniciativave të tilla dhe angazhimin e publikut të gjerë në to.

Duket se 42% e publikut të pyetur vlerëson se një përmirësim i proceseve të monitorimit dhe hetimit të shkeljeve mjedisore është thelbësor për të forcuar qeverisjen dhe sigurinë mjedisore (Fig. 42). Kjo mund të sugjerojë nevojën për rritjen e njohurive të publikut për identifikimin dhe raportimin e duhur të këtyre shkeljeve, rritjen e kapaciteteve të agjencive monitoruese dhe ligj-zbatuese, apo edhe përmirësime teknologjike në këtë fushë. 28% e të anketuarve shprehen se ekziston nevoja për të forcuar kuadrin ligjor dhe ndëshkueshmërinë, ndjekur nga 21% që shprehen se është nevoja që të rritet pjesëmarrja e publikut në proceset vendimmarrëse. Kjo sugjeron se ekzistojnë shqetësime lidhur me efikasitetin dhe fuqinë e ligjit aktual mjedisor, si dhe shpreh kërkesën për një përfshirje më të madhe dhe transparente të publikut në proceset vendimmarrëse të lidhura me mjedisin. Një pjesë më e vogël e pjesëmarrësve (7%) mendon se përmirësimi i koordinimit ndërmjet agjencive qeveritare dhe palëve të interesuara është një fushë që ndihmon në forcimin e qeverisjes dhe sigurisë mjedisore.

Një pjesë e vogël prej 2% ka dhënë sugjerime për

këtë tematikë duke përmendur nevojën për krijimin e një aplikacioni për të raportuar shkeljet mjedisore, fokusimin tek sistemi gjyqësor për ndëshkimin e këtyre shkeljeve, apo ngritjen e një strukture të veçantë në formën e një task force civile të përbërë nga qytetarë dhe organizata jo-fitimprurëse për monitorim dhe raportim të rasteve.

Siç tregojnë rezultatet, të dhënat theksojnë nevojën për t'u përqëndruar fuqimisht në përmirësimin e monitorimit, hetimin dhe forcimin e kuadrin ligjor mjedisor, si dhe për përfshirjen e mëtejshme të publikut në proceset vendimmarrëse. Kjo mund të jetë e rëndësishme për të adresuar shqetësimet në lidhje me zbatueshmërinë dhe efikasitetin e politikave mjedisore.

Siç tregohet në figurën 43, në mënyrë domethënëse, pjesa më e madhe (86%) e publikut të pyetur janë dakord nivele të ndryshme për të marrë pjesë aktive në nismat lokale për rritjen e sigurisë dhe mirë-qeverisjen mjedisore ose për të qenë vullnetar në organizata mjedisore. Një pjesë e vogël (9%) e pjesëmarrësve nuk shpreh ndonjë pozicion të qartë nëse do të ishin të hapur të marrin pjesë. Kjo mund të lidhet me mungesën e njohurive të mjaftueshme rreth aktiviteteve mjedisore lokale. Një pjesë më e vogël (5%) e pjesëmarrësve nuk është e hapur në nivele të ndryshme për të marrë pjesë në nisma lokale për rritjen e sigurisë dhe mirë-qeverisjen mjedisore. Kjo mund të jetë pasojë e mungesës së kohës ose informacionit.

Rezultatet tregojnë një interes të lartë dhe vullnet

Tabela 6. Në mendimin tuaj, çfarë roli duhet të luajnë institucionet publike në promovimin e qeverisjes mjedisore dhe si mund të angazhohen në mënyrë më efektive me publikun në proceset vendimmarrëse?

Nr.	Tematika	Veprimtaritë e propozuara
1	Ndërveprimi me publikun dhe bashkëpunimi institucional	<ul style="list-style-type: none"> <li>a. Takime periodike me publikun</li> <li>b. Përfshirja e publikut në proceset vendimmarrëse</li> <li>c. Sensibilizimi dhe edukimi i publikut për çështjet mjedisore</li> </ul>
2	Zbatimi i ligjit dhe ndëshkimi i shkelësve	<ul style="list-style-type: none"> <li>a. Zbatimi korrekt i legjislacionit mjedisor</li> <li>b. Ndëshkimi i atyre që dëmtojnë mjedisin</li> </ul>
3	Informacion transparent dhe i aksesueshëm	<ul style="list-style-type: none"> <li>a. Sigurimi i transparencës në vendimmarrjen mjedisore</li> <li>b. Publikimi i të dhënave dhe dokumenteve të lidhura me çështjet mjedisore</li> </ul>
4	Ndërgjegjësim dhe edukimi i publikut	<ul style="list-style-type: none"> <li>a. Fushatat ndërgjegjësuese dhe edukative për publikun</li> <li>b. Përdorimi i formave të ndryshme të komunikimit për të rritur ndërgjegjësimin</li> </ul>
5	Bashkëpunimi me bizneset, qytetarët dhe shoqërinë civile	<ul style="list-style-type: none"> <li>a. Bashkëpunimi me bizneset për menaxhimin e impaktit mjedisor</li> <li>b. Komunikimi dhe marrja e opinionëve nga qytetarët dhe bizneset</li> <li>c. Bashkëpunimi dhe përfshirja në propozimin e politikave dhe vendimeve të qëndrueshme</li> <li>d. Partneritetet me organizatat e shoqërisë civile për të forcuar proceset vendimmarrëse dhe ekspertizën</li> </ul>
6	Adresimi i korrupsionit	<ul style="list-style-type: none"> <li>a. Lufta kundër korrupsionit dhe pavarësia e organeve vendimmarrëse</li> </ul>
7	Konsultimi i publikut	<ul style="list-style-type: none"> <li>a. Organizimi i konsultimeve publike dhe diskutimeve të hapura</li> <li>b. Përdorimi i sondazheve publike dhe platformave online për të marrë opinionin e komunitetit</li> </ul>
8	Monitorimi dhe raportimi i performancës	<ul style="list-style-type: none"> <li>a. Institucionet të monitorojnë dhe raportojnë rendimentin e tyre për transparencë dhe përmirësim të vazhdueshëm</li> </ul>
9	Përdorimi i teknologjisë	<ul style="list-style-type: none"> <li>a. Mjetet moderne të komunikimit dhe teknologjia të përdoren për të arritur një audiencë më të gjerë dhe për të përfshirë më shumë publikun në proceset vendimmarrëse</li> </ul>

për pjesëmarrje aktive në nisma lokale dhe organizata mjedisore. Këto të dhëna mund të interpretohen në nevojën për krijimin e strategjive të komunikimit dhe ndërgjegjësimin për të inkurajuar më shumë pjesëmarrës në këto iniciativa.

Nga të dhënat e mbledhura del dukshëm nevoja për përmirësime në fusha të ndryshme për të rritur dijen dhe ndërgjegjësimin e publikur lidhur me qeverisjen dhe sigurinë mjedisore. Për të krijuar një kuptim më të mirë rreth mënyrës si mund të forcohet qeverisja dhe siguria mjedisore për të siguruar pajtueshmëri më të mirë, publiku u pyet për mendimin e tyre. Kjo ishte një pyetje jo e detyrueshme për pjesëmarrësit në anketim, në të cilën 71% kanë zgjedhur të përgjigjen. Në tabelën nr. 7 jepet lista e përgjigjeve e kategorizuar në tema të ndryshme së bashku me veprimet në të cilat publiku mendon se duhet të drejtohet fokusi.

Teknologjia dhe inovacioni përmenden në mënyrë të gjerë nga publiku në shumicën e pyetjeve të hapura të kësaj ankete. Kësaj tematike i është dedikuar një pyetje e veçantë me synimin për të vjelë qasjen, perceptimin, përdorimin dhe opinionin e publikut. 65% e pjesëmarrësve në anketë kanë përzgjedhur të përgjigjen. Tabela nr. 8 paraqet sugjerimet e të anketuarve për mënyrën si mund të shfrytëzohet teknologjia dhe inovacioni për të adresuar sfidat mjedisore dhe për të inkurajuar pajtueshmërinë me legjislacionin mjedisor.

Siç tregohet në tabelën 8 dhe 9, publiku propozon informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut si një nga mënyrat më të mira për të forcuar qeverisjen dhe sigurinë mjedisore për të siguruar pajtueshmëri më të mirë dhe si mjet për këtë mund të përdoren gjerësisht avancimet teknologjike.

Figura 42. Rëndësia e pjesëmarrjes së publikut



Figura 43. Kryerja e fushatave të ndërgjegjësimit




Figura 44. Cila nga këto fusha mendoni se kërkon përmirësim për të forcuar qeverisjen mjedisore dhe rritur sigurinë mjedisore?




Figura 45. A do të ishit të hapur të merrni pjesë aktive në nismat lokale për rritjen e sigurisë dhe mirë-qeverisjen mjedisore ose të jeni vullnetar/e në organizata mjedisore?




Tabela 7. Si mendoni se mund të forcohet qeverisja dhe siguria mjedisore për të siguruar pajtueshmëri më të mirë?

Nr.	Tematika	Veprimet e propozuara
1	Ligjet dhe rregulloret mjedisore	<ul style="list-style-type: none"> <li>a. Forcimi i legjislacionit dhe politikave mjedisore</li> <li>b. Zbatimi i ligjeve dhe politikave mjedisore</li> <li>c. Përmirësimi i kapaciteteve institucionale për monitorim dhe zbatim efikas</li> <li>d. Studimi i projekteve që ndërmerren nga institucionet publike dhe subjektet private përpara ndërhyrjes në mjedis</li> </ul>
2	Bashkëpunimi dhe pjesëmarrja e publikut	<ul style="list-style-type: none"> <li>a. Përfshirja e publikut në proceset vendimmarrëse</li> <li>b. Rritja e bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe organizatave jo-fitimprurëse</li> <li>c. Ndihma për inovacionin mjedisor përmes bashkëpunimit publik-privat</li> </ul>
3	Ndëshkimi i shkeljeve	<ul style="list-style-type: none"> <li>a. Ndëshkimi i rasteve të shkeljeve dhe kundërvajtjeve mjedisore</li> <li>b. Zbatimi më i fortë dhe i saktë i ligjit</li> <li>c. Vendosja e gjobave më të larta për shkelësit</li> </ul>
4	Ndërgjegjësimi i publikut	<ul style="list-style-type: none"> <li>a. Fushata ndërgjegjësimi dhe sensibilizimi të publikut nëpërmjet edukimit formal dhe jo-formal</li> <li>b. Edukimi i të rinjve dhe përfshirja e tyre në nisma mjedisore</li> <li>c. Ndërgjegjësim i vazhdueshëm dhe pa kufij administrativ për dëmin që kundërvajtjet mjedisore i shkaktojnë shoqërisë</li> </ul>
5	Informim dhe transparencë	<ul style="list-style-type: none"> <li>a. Informim i publikut dhe transparencë në proceset vendimmarrëse</li> <li>b. Monitorim dhe raportim i rasteve të ndotjes së mjedisit</li> <li>c. Informimi i qytetarëve në të gjitha mënyrat/ platformat e ndryshme</li> </ul>
6	Bashkëpunim institucional	<ul style="list-style-type: none"> <li>a. Forcimi i institucioneve që veprojnë në sigurinë mjedisore</li> <li>b. Bashkëveprim dhe koordinim ndërinstitutional</li> <li>c. Lobim tek institucionet përgjegjëse</li> <li>d. Konsultim dhe përfshirje e publikut në hartimin e politikave mjedisore</li> <li>e. Forcimi i bashkëpunimit mes qytetarëve, shoqërisë civile, institucioneve publike qendrore dhe lokale</li> <li>f. Krijimi i rrjeteve efikase me aktorë të ndryshëm për të rritur sigurinë mjedisore</li> </ul>
7	Lufta ndaj korrupsionit dhe drejtësia	<ul style="list-style-type: none"> <li>a. Lufta kundër korrupsionit në kuadër të zbatimit të legjislacionit mjedisor</li> <li>b. Lufta kundër korrupsionit dhe ryshfetit në sektorin që prek drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt mjedisin</li> </ul>

Tabela 8. Si mund të shfrytëzohet teknologjia dhe inovacioni për të adresuar sfidat mjedisore dhe për të inkurajuar pajtueshmërinë me legjislacionin mjedisor?

Nr.	Tematika	Veprimet e propozuara
1	Fokusi në inovacionin dhe teknologjinë mjedisore	<ul style="list-style-type: none"> <li>a. Trajnim dhe edukim rreth përdorimit të teknologjisë mjedisore</li> <li>b. Politika për inkurajimin e inovacioneve të lidhura me mjedisin</li> </ul>
2	Identifikimi dhe monitorimi i shkeljeve	<ul style="list-style-type: none"> <li>a. Përdorimi i teknologjisë për të mbledhur të dhënave për monitorim dhe vlerësim mjedisor</li> <li>b. Zbatimi i projekteve mjedisore lokale</li> <li>c. Monitorimi i ndotjes duke përdorur dron dhe GPS</li> </ul>
3	Raportimi i shkeljeve	<ul style="list-style-type: none"> <li>a. Krijimi dhe përdorimi i aplikacioneve për raportim në kohë</li> <li>b. Përdorimi i fotove ajrore dhe kamerave</li> </ul>
4	Platformat e bashkëpunimit	<ul style="list-style-type: none"> <li>a. Përdorimi i platformave digjitale dhe rrjetet sociale si mjete për bashkëpunim dhe shpërndarje të informacionit midis qytetarëve, OJQ, dhe institucioneve publike</li> </ul>
5	Ndërgjegjësimi i publikut	<ul style="list-style-type: none"> <li>a. Publikime në media sociale për të rritur ndërgjegjësimin</li> <li>b. Informimi i qytetarëve për sfidat mjedisore nëpërmjet rrjeteve sociale dhe medias</li> <li>c. Krijimi i video-ve të dedikuara për ndotjen/ dëmtimin e mjedisit</li> <li>d. Përdorimi i teknologjisë përgjatë fushatave ndërgjegjësuere</li> <li>e. Krijimi i mjedisëve demonstrative për pasojat që shkaktojnë dëmet në mjedis</li> </ul>
6	Vendimmarrja mjedisore	<ul style="list-style-type: none"> <li>d. Aplikacione për të inkurajuar ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjen e publikut</li> <li>a. Përfshirja e teknologjisë në proceset vendimmarrëse</li> </ul>

4

# KONKLUZIONE

Më poshtë paraqiten konkluzionet nga anketimi i hapur gjithëpërfshirës për të vlerësuar dijet dhe ndërgjegjësimin e publikut rreth qeverisjes dhe sigurisë mjedisore i kryer në kuadër të projektit “Forcimi i Qeverisjes dhe Sigurisë Mjedisore në Shqipëri” të zbatuar nga Prezenca e OSBE në Shqipëri.

- Anketa ka një pjesëmarrje më të lartë të grave (61%) krahasuar me burrat (39%), ku grup-mosha 28-37 vjeç përbën pjesën më të madhe të personave që janë përgjigjur (36%).
- Studimi paraqet një mbulim kombëtar me pjesën më të madhe prej 39% të të anketuarve që banojnë në Qarkun e Tiranës, ndjekur nga Qarku i Fierit me 14%. Qarku më pak i përfaqësuar është ai i Vlorës me 2%.
- 86% e pjesëmarrësve në anketim shprehen jashtëzakonisht të shqetësuar ose të shqetësuar për problematikat mjedisore, ndërkohë që 8% shprehen neutral, 5% pak të shqetësuar dhe vetëm 1% jo të shqetësuar. Shumica e atyre që shprehen “jashtëzakonisht të shqetësuar” kërkojnë informacion çdo ditë, ndërsa ata që shprehen “shumë të shqetësuar” kërkojnë informacion çdo javë. Ndërsa, pjesëmarrësit që shprehen neutral apo jo të shqetësuar kërkojnë informacion më rrallë se një herë në muaj.
- Të pyetur për burimet e informacionit, 62% e personave që përgjigjen deklarojnë se hasin vështirësi në gjetjen e burimeve të besueshme dhe 41% se marrin informacione të ndryshme për të njëjtën çështje nga burime të ndryshme. Në Tiranë, duket se përqindja më e lartë e informacionit vjen nga platformat e mediave sociale (28%), faqet e lajmeve në internet (26%) dhe televizioni (17%). Nga ana tjetër, në qarqe si Gjirokastra dhe Lezha, përqindja e përgjigjeve për përdorimin e platformave të mediave sociale është relativisht më e ulët, duke u përqëndruar më tepër tek televizioni dhe faqet e lajmeve në internet, respektivisht.
- Problematikat më të mëdha mjedisore me të cilat komunitetet/ zona e tyre përballen janë ndotja e ajrit, e ujërave dhe/ose e tokës (83%), ndjekur nga transporti dhe menaxhimi i mbetjeve (65%), prerja, shkatërrimi dhe/ ose zjarrvënja në pyje (42%), dëmtimi i habitateve dhe/ ose i llojeve të mbrojtura (31%), aktivitete që çojnë në lëshimin e substancave toksike (20%) dhe kryerja e aktiviteteve minerare (20%).
- Të pyetur për mendimin e tyre lidhur me cilin nga problemet konsiderojnë si më domethënëse; problemi më domethënëse në kuadër të kundërvajtjeve mjedisore duket se është mungesa e ndërgjegjësimit për problematikat mjedisore (53%), mos-reagimi nga institucionet kur një problem raportohet (32%), mungesa e dijeve rreth mënyrës së raportimit (9%), mungesa e informacionit mjedisor (4%) apo edhe diçka tjetër (1%).
- 73% e pjesëmarrësve thonë se kanë përjetuar ose parë kryerjen e një dëmi në mjedisin e zonës së tyre nga persona ose subjekte, ndërkohë që vetëm 43% përqind e tyre thonë se e kanë raportuar këtë tek institucionet zyrtare.
- Në Tiranë, 31% e pjesëmarrësve shprehen se janë të interesuar për të patur më shumë informacion rreth e ndotjes së ajrit, ujërave, dhe tokës, ndërkohë që transporti dhe menaxhimi i mbetjeve zënë 22%, dëmtimi i zonave të mbrojtura dhe llojeve të mbrojtura 18%, dhe prerja, shkatërrimi apo zjarrvënja në pyje 17%. Në Fier, ndotja e ajrit, ujit dhe tokës zënë 12% dhe menaxhimi i mbetjeve 7%. Në qytetet e tjera, si Shkodra dhe Durrësi, tematika të tilla si dëmtimi i habitateve dhe kryerja e aktiviteteve minerare paraqiten si shqetësime domethënëse.
- Koncepti “siguri mjedisore” është koncepti më i vështirë për t’u kuptuar nga publiku (99.91% normë përgjigje), ndjekur nga “qeverisje mjedisore” (99.92% normë përgjigje) dhe “krim mjedisor” (99.94% normë përgjigje).
- Shumica prej 79% vlerëson se të gjitha grupet



preken në mënyrë të njëjtë nga shkeljet apo krimet mjedisore, ndjekur nga 18% që shprehen se gratë dhe vajzat preken në mënyrë më të theksuar dhe 3% shprehen burrat dhe djemtë. Perceptimi i grave për ndikimin që shkeljet apo krimet mjedisore kanë ndaj gjinisë së tyre është i ndryshëm nga ai i burrave, ku prej të anketuarve që janë përgjigjur se më të prekura janë gratë dhe vajzat, 83% janë gra dhe 17% janë burra.

- 94% besojnë se korrupsioni në institucionet publike ka ndikim në shkeljet/ krimet mjedisore, përkundrajt 6% që mendojnë se nuk ka ndikim.
- 76% e të anketuarve shprehen se kanë hasur në raste kur zbatimi i dobët i legjislacionit mjedisor vjen për shkak të korrupsionit, përkundrajt 24% që thonë se nuk kanë hasur raste të tilla.
- 10% e banorëve të Qarkut Tiranë konfirmojnë se kanë përjetuar ose dijnë për raste të korrupsionit në zonën e tyre të banimit. Në anën tjetër, qytetarët e qyteteve si Berati, Dibra, Durrësi dhe Lezha raportojnë një përjetim të ulët të rasteve të tilla, secila me 1%. Po ashtu, 23% e pjesëmarrësve banues në Qarkun Tiranë përgjigjen se kanë dëgjuar për raste të korrupsionit përmes miqve ose familjarëve, duke treguar për një ndikim të fuqishëm të informacionit të përhapur nga kanale jozyrtare.
- 90% e të anketuarve mendojnë se adresimi i korrupsionit është thelbësor për të përmirësuar qeverisjen mjedisore dhe për të parandaluar shkeljet mjedisore.
- 94% e të anketuarve shprehen se janë në dijeni për raste kur individë ose biznese kanë përdorur rryshfet për t'iu shmangur rregullave ose ndëshkimeve mjedisore, por 79% deklarojnë se nuk e kanë raportur këtë gjë.
- **90% e të anketuarve mendojnë se kryerja e fushatave të ndërgjegjësimit dhe nismave për edukim të lidhura me qeverisjen dhe sigurinë mjedisore do të ndikojnë pozitivisht në angazhimin e publikut në përpjekjet për mbrojtjen e mjedisit dhe raportimin e dëmeve ose krimeve në mjedis.**
- 86% e publikut të pyetur janë të hapur ose disi të hapur për të marrë pjesë aktive në nismat lokale për rritjen e sigurisë dhe mirë-qeverisjen mjedisore ose për të qenë vullnetar në organizata mjedisore.
- Në pyetjet e hapura, publiku propozon informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut si një nga mënyrat më të mira për të forcuar qeverisjen dhe sigurinë mjedisore për të siguruar pajtueshmëri më të mirë dhe si mjet për këtë mund të përdoren gjerësisht avancimet teknologjike.

Duke analizuar rezultatet e përgjithshme të përfuara

nga anketa, si dhe komentet e shkruara nga publiku në pyetjet e hapura, më poshtë jepen rekomandimet kryesore që synojnë të adresojnë sfidat e identifikuara nga anketa dhe të përmirësojnë ndërgjegjësimin dhe përfshirjen e publikut në përpjekjet për rritjen e sigurisë dhe mirë-qeverisjen e mjedisit në Shqipëri.

#### 4.1. Ndërgjegjësim dhe shpërndarje e informacionit mjedisor

**Përmbledhje:** Fushatat ndërgjegjësuese duhet të përqendrohen në arritjen e të gjithë grupeve sociale, gjinore dhe gjeografike. Fokusi duhet të drejtohet në informimin e publikur rreth terminologjisë, burimit të informacionit të besueshëm mjedisor dhe raportimit të shkeljeve. Rekomandohet përdorimi i mjeteve të ndryshme dhe kombinimi i fushatave ndërgjegjësuese në terren dhe virtuale. Po ashtu, materialet elektronike mund të shfaqen përgjatë fushatave në terren.

Mjetet për fushatën në terren: Organizimi i eventeve informuese, punëtorive, panairëve mjedisore lokale dhe sesioneve të informimit nëpër qytete dhe fshatra.

Mjetet për fushatën virtuale/ online: Krijimi i materialeve informuese (video, audio, të shkruara) për konceptet e ndryshme që kanë të bëjnë me sigurinë dhe qeverisjen mjedisore, mënyrën si publiku mund të dallojë informacionet e vërteta nga ato jo të vërteta, si dhe mënyrën si mund të raportohen shkeljet mjedisore.

#### 4.2. Ndërgjegjësim për efektin e shkeljeve mjedisore ndaj grave dhe vajzave

**Përmbledhje:** Me 71% të pjesëmarrësve që besojnë se shkeljet mjedisore kanë ndikime të ndryshme tek persona të ndryshëm bazuar në gjininë dhe rrethanat shoqërore, një fushatë e veçantë duhet të fokusohet në efektin që shkeljet mjedisore kanë ndaj grave dhe vajzave. Sugjerohet fushata komunikimi dhe ndërgjegjësimi specifike dhe të drejtuara tek ndërlidhjet midis shkeljeve mjedisore dhe grupeve gjinore, të cilat do të rritin njohurinë e publikut në përgjithësi, si dhe përfshirjen e grave në iniciativat mjedisore në veçanti.

Mjetet për fushatën në terren: Organizimi i takimeve/ eventeve lokale me pjesëmarrjen e grave dhe vajzave ku atyre u jepet hapësirë për të ndarë përvojat dhe sugjerime për zgjidhje.

Mjetet për fushatën virtuale/ online: Krijimi i një hashtagu unik për fushatën, ku gra dhe vajza mund të ndajnë përvojat dhe sugjerime, duke e ndërthurur me histori personale. Përdorimi i mediave sociale dhe medias për të promovuar historitë dhe eventet lokale.

### 4.3. Adresimi i rolit të korrupsionit në shkeljet mjedisore.

- **Përmbledhje:** Duke patur në konsideratë se 94% e pjesëmarrësve në anketë mendojnë se korrupsioni në institucionet publike ka ndikim në shkeljet mjedisore, sugjerohet krijimi i një fushate informuese për publikun me fokus mënyrën si mund dhe duhet të raportojnë raste të tilla. Komunikimi i rasteve specifike kur korrupsioni ka ndikuar në zbatimin e dobët të legjislacionit mjedisor do të fuqizojë kërkesën për transparencë dhe përgjegjësi.

Mjetet për fushatën në terren: Organizimi i diskutimeve me komunitetet dhe ekspertët lokalë në lidhjen mes korrupsionit dhe shkeljeve mjedisore, mjeteve për raportim dhe rastet e suksesit.

Mjetet për fushatën virtuale/ online: Përdorimi i rrjeteve sociale për të promovuar raportimet e rasteve specifike dhe organizimi i bisedave live në rrjetet sociale me ekspertë të fushës dhe aktivistë.

### 4.4. Forcimi i rolit të komunitetit në adresimin e shkeljeve mjedisore.

- **Përmbledhje:** Duke pasur parasysh nivelin e lartë të shqetësimit (Fig. 7) të pjesëmarrësve në anketë dhe kërkesën për më shumë informacion për tematika të veçanta në qarqe të ndryshme (Fig. 23), sugjerohen fushata ndërgjegjësuere të përqendruara në nevojat specifike të çdo zone. Përmes takimeve me komunitetet lokale, punëtorive dhe eventeve informuese, komunitetet mund të aktivizohen dhe të ndjehen pjesë e zgjidhjeve për shqetësimet e

tyre mjedisore. Forcimi i rolit të komunitetit lokal do të ndihmojë në rritjen e ndërgjegjësimit dhe angazhimit të qytetarëve në projekte dhe aktivizim mjedisor.

Mjetet për fushatën në terren: Takimet në nivel lokal, punëtori, panairë dhe evente mjedisore në të cilat komunitetet mund të ndajnë informacionin dhe shqetësimet e tyre.

Mjetet për fushatën virtuale/ online: Krijimi i faqejeve online nga OJF-të lokale për informimin dhe përfshirjen e komunitetit, duke përdorur teknologjitë e transmetimit në drejtpërdrejtë për diskutime, raportime dhe prezantime që mund të ndihmojnë komunitetet më të largëta të marrin pjesë në fushatën.

# LITERATURA

1. Acharya, A. S., Prakash, A., Saxena, P., & Nigam, A. (2013). Sampling: Èhy and hoë of it. *Indian Journal of Medical Specialties*, 4(2), 330-333. DOI: 10.7713/ijms.2013.0032
2. DCAF, OSCE/ODIHR, UN Women (2019) "Justice and Gender", in Gender and Security Toolkit. Geneva: DCAF, OSCE/ODIHR, UN Women, web <https://www.unwomen.org/sites/default/files/Headquarters/Attachments/Sections/Library/Publications/2019/GS-toolkit-Tool-04-en.pdf>
3. EUROPOL, web. <https://www.europol.europa.eu/crime-areas-and-statistics/crime-areas/environmental-crime#:~:text=Environmental%20crime%20covers%20the%20gamut,%2C%20human%20health%2C%20or%20both>
4. Financial Crime Academy, web: <https://financialcrimeacademy.org/bribery-and-corruption-3/#:~:text=Bribery%20involves%20giving%20or%20receiving,through%20illegal%20or%20unethical%20means>.
5. Griffin, A., Barczak, G. Effective review for conceptual journal submissions. *AMS Rev* 10, 36-48 (2020). <https://doi.org/10.1007/s13162-020-00162-z>
6. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
7. Ministria e Mjedisit 2013, fq. 1.
8. "Mbi çështjet mjedisore në Bashkinë e Tiranës – Raport përmbledhës i sondazhit". Mars 2019. Fq. 5.
9. NATO. "The Secretary General's Report. Climate Change & Security Impact Assessment." NATO Web. 28 June 2022. [https://www.nato.int/nato-static\\_files/2014/assets/pdf/2022/6/pdf/280622-climate-impact-assessment.pdf](https://www.nato.int/nato-static_files/2014/assets/pdf/2022/6/pdf/280622-climate-impact-assessment.pdf)
10. Raporti i Prokurorisë së Përgjithshme. Mars 2023. Fq 144
11. Raporti i Prokurorisë së Përgjithshme. Mars 2022. Fq 141
12. Rahi, S. (2017). Research design and methods: A systematic review of research paradigms, sampling issues and instruments development. *International Journal of Economics & Management Sciences*, 6(2), 1-5. DOI: 10.4172/2162-6359.1000403
13. Sharma, G. (2017). Pros and cons of different sampling techniques. *International journal of applied research*, 3(7), 749-752. <https://www.allresearchjournal.com/archives/2017/vol3issue7/PartK/3-7-69-542.pdf>
14. Stockemer, D., Stockemer, G., & Glaeser. (2019). Quantitative methods for the social sciences (Vol. 50, p. 185). Quantitative methods for the social sciences: Springer International Publishing
15. Thompson, S.T. The Convergence of Environmental Crime and Corruption: An Operational Typology. *Int Criminol* 3, 133-148 (2023). <https://doi.org/10.1007/s43576-023-00093-2>
16. UNICEF Procedure On Ethical Standards In Research, Evaluation, Data Collection And Analysis (2021)

# SHTOJCA I. PYETËSORI

## Njohja dhe ndërgjegjësimi i publikut mbi qeverisjen dhe sigurinë mjedisore

*Prezenca e OSBE në Shqipëri, në kuadër të projektit "Forcimi i Qeverisjes dhe Sigurisë Mjedisore në Shqipëri", po kryen një studim për të kuptuar njohjen dhe ndërgjegjësimin e publikut të gjerë për çështjet e sigurisë dhe qeverisjes mjedisore. Plotësimi i pyetëorit do të zgjasë rreth 15 minuta. Përgjigjet tuaja do të na ndihmojnë të identifikojmë fushat për përmirësim dhe të krijojmë strategji më të mira për të adresuar sfidat mjedisore. Të gjitha të dhënat e mbledhura në këtë pyetësor janë rreptësisht për qëllime studimore dhe do të analizohen me konfidencialitet të plotë në përputhje me ligjin nr. 9887 të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë për "Mbrotjen e të Dhënave Personale".*

## Pjesa I – Njohja dhe ndërgjegjësimi

### 1. Sa i/e shqetësuar jeni për problematikat mjedisore\*?

- Shumë i/e shqetësuar
- Jashtëzakonisht i/e shqetësuar
- As i/e shqetësuar, as jo i/e shqetësuar
- Pak i/e shqetësuar
- Aspak i/e shqetësuar

### 2. Sa shpesh kërkon informacion rreth çështjeve mjedisore\*?

- Çdo ditë
- Çdo javë
- Çdo muaj

- Më rrallë se 1 herë në muaj
- Kurrë

### 3. Cilat janë mjetet kryesore përmes së cilave merrni informacione rreth çështjeve mjedisore\*? [Përzgjidhni deri në 3 mundësi]

- Televizioni
- Faqet e lajmeve në internet
- Platformat e mediave sociale
- Faqet e internetit të organizatave mjedisore
- Gazeta/ revista të shtypura
- Përmes bisedave me miq, familjar, kolegë
- Tjetër (specifiko)

### 4. Cilat është pengesa apo sfida kryesore me të cilën përballeni kur kërkon informacion për çështjet mjedisore\*? [Përzgjidhni deri në 3 mundësi]

- Sasi shumë e madhe informacioni
- Gjuha teknike e përdorur
- Vështirësi në gjetjen e burimeve të besueshme
- Nuk kam kohë për të qëndruar i/e përditësuar
- Informacione të ndryshme për të njëjtën çështje nga burime të ndryshme
- Qasje e kufizuar në internet ose media
- Mungesa e interesit dhe/ ose motivimit
- Tjetër (specifiko)

### 5. Cilat janë problematikat më të mëdha mjedisore me të cilat komuniteti/ zona juaj përballlet\*? [Përzgjidhni deri në 3 mundësi]

- Ndotja e ajrit, e ujërave dhe/ ose e tokës
- Transporti dhe menaxhimi i mbetjeve
- Kryerja e aktiviteteve minerare
- Prerja, shkatërrimi dhe/ ose zjarrëvënia në pyje

- Dëmtimi i habitateve në zonat e mbrojtura dhe/ose i llojeve të florës dhe faunës të mbrojtura
- Aktivitete që çojnë në lëshimin e substancave toksike për njeriun dhe mjedisin (për shembull, substanca radioaktive, ozonholluese, etj.)
- Tjetër (specifiko)

**6. Çfarë kuptoni me “qeverisje mjedisore”?**

---

**7. Çfarë kuptoni me “siguri mjedisore”?**

---

**8. Çfarë kuptoni me “krim mjedisor”?**

---

**9. A keni marrë pjesë ndonjëherë në një fushatë apo iniciativë ndërgjegjësimi të lidhur me çështje mjedisore, sigurinë dhe/ose qeverisjen mjedisore?\***

- Po
- Jo

**10. A keni keni ndërvepruar me institucionet përgjegjëse për çështjet mjedisore (për shembull nëpërmjet pjesëmarrjes në konferenca, takime konsultuese, etj.), përfshirë tematikat e sigurisë dhe qeverisjes mjedisore?\***

- Po, shumë herë
- Po, një herë
- Jo, asnjëherë

**11. Sa shpesh bisedoni me miqtë, familjen ose kolegët për çështje të lidhura me qeverisjen dhe sigurinë mjedisore, apo çështje të tjera që lidhen me mjedisin?\***

- Çdo ditë
- Çdo javë
- Çdo muaj
- Më rrallë se 1 herë në muaj
- Kurrë

**12. Në mendimin tuaj, cili nga problemet e mëposhtme është më domethënës?\***

- Mungesa e informacionit mjedisor
- Mungesa e ndërgjegjësimit për problematikat mjedisore
- Mungesa e dijeve rreth mënyrës së raportimit për problematikat mjedisore
- Mos-reagimi nga institucionet kur një problem raportohet
- Tjetër (specifiko)

**13. A keni dijeni se në Shqipëri ekziston një kuadër ligjor për monitorimin dhe dënimin e krimeve mjedisore?\***

- Po
- Jo

**14. Sipas vlerësimit tuaj, sa efektive është qeverisja mjedisore dhe zbatimi i politikave lidhur me sigurinë mjedisore në Shqipëri, në një shkallë nga 1 në 5? (ku 1 = shumë jo efektive, 5 = shumë efektive)**

- Shumë jo efektive
- Jo efektive
- As jo efektive, as efektive
- Disi efektive
- Shumë efektive

**15. Keni përjetuar/ parë kryerjen e një dëmi në mjedisin e zonës suaj nga persona ose subjekte?\***

- Po [kalo tek pyetja nr. 16]
- Jo [kalo tek pyetja nr. 17]
- Nuk jam i/e sigurt [kalo tek pyetja nr. 17]

**16. A e keni raportuar këtë dëm mjedisor?**

- Po, tek institucionet zyrtare
- Po, tek të njohurit e mi
- Jo, nuk e kam raportuar

**17. Rreth cilave çështje të lidhura me qeverisjen dhe sigurinë mjedisore do të donit të kishit më shumë informacion? [Përzgjidhni deri në 3 mundës]**

- Ndotja e ajrit, e ujërave dhe/ ose e tokës
- Transporti dhe menaxhimi i mbetjeve
- Kryerja e aktiviteteve minerare
- Prerja, shkatërrimi dhe/ ose zjarrvënja në pyje
- Dëmtimi i habitateve në zonat e mbrojtura dhe/ ose i llojeve të florës dhe faunës të mbrojtura
- Aktivitete që çojnë në lëshimin e substancave toksike për njeriun dhe mjedisin (për shembull, substanca radioaktive, ozonholluese, etj.)
- Tjetër (specifiko)

- Kanë shumë ndikim
- Kanë ndikim
- Jam asnjëanës/e
- Nuk kanë ndikim
- Nuk kanë fare ndikim

## Pjesa II – Çështjet gjinore dhe shkeljet mjedisore/ krimet mjedisore

**18. A besoni se shkeljet/ krimet mjedisore mund të kenë ndikime të ndryshme tek persona të ndryshëm bazuar në gjininë dhe rrethanat e tyre shoqërore?\***

- Po
- Jo

**19. Sipas mendimit tuaj, cilat grupe preken në mënyrë më të theksuar nga shkeljet/ krimet mjedisore? \***

- Gratë dhe vajzat
- Burrat dhe djemtë
- Të gjithë preken në mënyrë të njëjtë

**20. A keni hasur në raste kur shkeljet/ krimet mjedisore kanë krijuar pabarazi gjinore; si qasja e kufizuar e grave në burime natyrore, udhëtime më të gjata për të siguruar ushqim dhe ujë, rritje e riskut për gratë që punojnë në bujqësi/ blegtori, etj.?\***

- Po
- Jo

**21. Sa mendoni se normat shoqërore dhe kulturore ndikojnë në rritjen e cënueshmërisë ndaj grave për shkak të shkeljeve/ krimeve mjedisore (për shembull, roli i gruas në kujdesin për familjen dhe fëmijët, gatimin, pastrimin, sigurimin e të ujit dhe ushqimit, etj.)?\***

**22. Sipas mendimit tuaj, a duhet që politikat mjedisore dhe ndëshkimet ndaj shkeljeve/ krimeve mjedisore të marrin parasysh gjithashtu qasjen gjinore për të siguruar drejtësi të barabartë për të gjithë?\***

- Jam shumë dakord
- Jam dakord
- Jam asnjëanës/e
- Nuk jam dakord
- Nuk jam aspak dakord

**23. Sa e rëndësishme mendoni se është që organizatat jo-fitimprurëse me fokus çështjet gjinore dhe autoritetet publike të bashkëpunojnë kur trajtojnë shkeljet/ krimet mjedisore?\***

**24. Si mendoni se mund të ndikojnë institucionet arsimore dhe kurrikulat që përdoren prej tyre për të përfshirë çështjet gjinore në ndërgjegjësimin mjedisor?\***

## Pjesa III – Roli i korrupsionit në shkeljet / krimet mjedisore

**25. A besoni se korrupsioni në institucionet publike ndikon në shkeljet mjedisore?\***

- Po
- Jo

**26. A jeni në dijeni të rasteve kur korrupsioni është i lidhur me aktivitete të tilla si prerja e pyjeve, zjarrvënja, hedhja e mbeturinave, ndotja e ajrit, etj.?\***

- Po, ka raste të tilla në zonën ku banoj



- Po, kam dëgjuar për raste të tilla nga miq/ familjar/ media
- Jo, nuk kam dijeni për raste të tilla

**27. A keni hasur në raste kur zbatimi i dobët i legjislacionit mjedisor vjen për shkak të korrupsionit?\***

- Po
- Jo
- Nuk jam i/e sigurt

**28. A mendoni se adresimi i korrupsionit është thelbësor për të përmirësuar qeverisjen mjedisore dhe parandalimin e shkeljeve/ krimeve mjedisore?\***

- Po
- Jo

**29. Sa të kënaqur jeni me rolin e agjencive ligjzbatuese në luftën ndaj korrupsionit në shkeljet/ krimet mjedisore (Bashkia, Inspektorati Mjedisor, Policia, Prokuroria, Gjykata)?\***

- Shumë i/e kënaqur
- Disi i/e kënaqur
- Asnjëanës/e
- Disi i/e pakënaqur
- Shumë i/e pakënaqur

**30. A njihni organizata që punojnë në luftën ndaj korrupsionit të lidhur me shkeljet/ krimet mjedisore dhe/ose mirë-qeverisjen mjedisore?\***

- Po
- Jo

**31. A jeni në dijeni për raste kur individë ose biznese kanë përdorur ryshfet për t'iu shmangur rregullave ose ndëshkimeve mjedisore?\***

- Po [vazhdo tek pyetja 32]
- Jo [vazhdo tek pyetja 33]

**32. A e keni raportuar këtë gjë?**

- Po
- Jo

**33. Në mendimin tuaj, sa i rëndësishëm është bashkëpunimi midis institucioneve dhe publikut në adresimin e korrupsionit lidhur me shkeljet/ krimet mjedisore?\***

- Shumë i rëndësishëm
- Disi i rëndësishëm
- As i rëndësishëm, as jo i rëndësishëm
- Jo i rëndësishëm
- Aspak i rëndësishëm

**34. Në mendimin tuaj, çfarë roli duhet të luajnë institucionet publike në promovimin e qeverisjes mjedisore dhe si mund të angazhohen në mënyrë më efektive me publikun në proceset vendimmarrëse?**

---

## Pjesa IV – Sugjerime për përmirësim

**35. A mendoni se publiku/ qytetarët luajnë një rol të rëndësishëm në qeverisjen dhe sigurinë e mjedisit?\***

- Po
- Jo

**36. A mendoni se kryerja e fushatave të ndërgjegjësimit dhe nismave për edukimin për qeverisjen dhe sigurinë mjedisore do të ndikonin pozitivisht në angazhimin e publikut në përpjekjet për mbrojtjen e mjedisit dhe raportimin e dëmeve/ krimeve në mjedis?\***

- Po
- Jo
- Nuk jam i/e sigurt



**37. Cila nga fushat e mëposhtme mendoni se kërkon përmirësim për të forcuar qeverisjen mjedisore dhe rritur sigurinë mjedisore\*?**

- Forcimi i kuadrit ligjor dhe i ndëshkueshmërisë
- Rritja e monitorimit dhe mbikëqyrjes së shkeljeve mjedisore
- Rritja e pjesëmarrjes së publikut në proceset vendimmarrëse
- Përmirësimi i koordinimit ndërmjet agjencive qeveritare dhe palëve të interesuara
- Tjetër (specifiko)

**38. A do të ishit të hapur të merrni pjesë aktive në nismat lokale për rritjen e sigurisë dhe mirë-qeverisjen mjedisore ose të jeni vullnetar/e në organizata mjedisore\*?**

- Jam i/e hapur të jem pjesë
- Jam disi i/e hapur të jem pjesë
- Jam asnjëanës/e
- Nuk jam i/e hapur të marr pjesë
- Nuk jam aspak i/e hapur të marr pjesë

**39. Si mendoni se mund të forcohet qeverisja dhe siguria mjedisore për të siguruar pajtueshmëri më të mirë?**

---

**40. Si mund të shfrytëzohet teknologjia dhe inovacioni për të adresuar sfidat mjedisore dhe për të inkurajuar pajtueshmërinë me legjislacionin mjedisor?**

---

## Pjesa V – Të dhëna demografike

**41. Gjinia\*:**

- Femër
- Mashkull
- Tjetër (specifiko)

**42. Group-mosha\*:**

- 18 – 27
- 28 – 37
- 38 – 47
- 48 – 57
- 58 – 67
- 68 – 77
- 77+

**43. Qarku ku banoni\*:** [listë e paracaktuar me 12 qarqe, përzgjedhje e një opsioni]

**44. Bashkia ku banoni\*:** [listë e përcaktuar, në varësi të pyetjes 44]

**45. Profesionin\*:**

- Student
- I/e punësuar me kohë të plotë
- I/e punësuar me kohë të pjesshme
- I/e vetë-punësuar
- I/e papunë
- Në pension
- Tjetër (specifiko)

**46. Niveli më i lartë i edukimit i arritur\*:**

- Shkollë fillore ose tetë/ nëntë-vjeçare
- Shkollë e mesme
- Shkollë profesionale
- Diplomë universitare
- Diplomë pas-universitare
- Tjetër (specifiko)

**47. Adresa juaj email: [jo e detyruar]**

*Ju pranoni që autorët të mund t'ju kontaktojnë për të shpërndarë rezultatet e studimit.*

---

## Lista e tabelave

• <b>Tabela 1.</b> Fushat kryesore të vlerësimit dhe indikatorët përkatës	15
• <b>Tabela 2.</b> Popullsia e Shqipërisë në nivel qarku (KQZ, 2019)	18
• <b>Tabela 3.</b> Çfarë kuptoni me “qeverisje mjedisore”, “siguri mjedisore” dhe “krim mjedisor”?	34
• <b>Tabela 4.</b> Sa e rëndësishme mendoni se është që organizatat jo-fitimprurëse me fokus çështjet gjinore dhe autoritetet publike të bashkëpunojnë kur trajtojnë shkeljet/ krimet mjedisore?	38
• <b>Tabela 5.</b> Si mendoni se mund të ndikojnë institucionet arsimore dhe kurrikulat që përdoren prej tyre për të përfshirë çështjet gjinore në ndërgjegjësimin mjedisor?	38
• <b>Tabela 6.</b> Në mendimin tuaj, çfarë roli duhet të luajnë institucionet publike në promovimin e qeverisjes mjedisore dhe si mund të angazhohen në mënyrë më efektive me publikun në proceset vendimmarrëse?	44
• <b>Tabela 7.</b> Si mendoni se mund të forcohet qeverisja dhe siguria mjedisore për të siguruar pajtueshmëri më të mirë?	46
• <b>Tabela 8.</b> Si mund të shfrytëzohet teknologjia dhe inovacioni për të adresuar sfidat mjedisore dhe për të inkurajuar pajtueshmërinë me legjislaionin mjedisor?	47

## Lista e figurave

• <b>Figura 1.</b> Kuadri metodologjik i zbatuar	16
• <b>Figura 2.</b> Gjinia e personave që janë përgjigjur	21
• <b>Figura 3.</b> Grup-mosha	21
• <b>Figura 4.</b> Qarku ku banojnë të anketuarit	22
• <b>Figura 5.</b> Punësimi	23
• <b>Figura 6.</b> Niveli më i lartë i edukimit të arritur	23
• <b>Figura 7.</b> Sa i/e shqetësuar jeni për problematikat mjedisore?	23
• <b>Figura 8.</b> Niveli i shqetësimit për problematikat mjedisore sipas gjinisë	24
• <b>Figura 9.</b> Sa shpesh kërkoni informacion rreth çështjeve mjedisore?	24
• <b>Figura 10.</b> Shpeshësia e kërkimit të informacionit sipas nivelit të shqetësimit	25
• <b>Figura 11.</b> Cilat janë mjetet kryesore përmes së cilave merrni informacione rreth çështjeve mjedisore?	25
• <b>Figura 12.</b> Burimi i informacionit sipas qarkut, në qarqet më të përfaqësuar	26
• <b>Figura 13.</b> Sa shpesh bisedoni për qeverisjen dhe sigurinë mjedisore?	27
• <b>Figura 14.</b> Cila është pengesa apo sfida kryesore me të cilën përballeni kur kërkoni informacion për çështjet mjedisore?	28
• <b>Figura 15.</b> Cilat janë problematikat më të mëdha mjedisore me të cilat komuniteti/ zona juaj përballlet?	28
• <b>Figura 16.</b> Problematikat mjedisore sipas qarkut	29
• <b>Figura 17.</b> Pjesëmarrja në fushata ndërgjegjësimi	30
• <b>Figura 18.</b> Ndërveprimi me institucione përgjegjëse	30
• <b>Figura 19.</b> Problemet më domethënëse sipas të anketuarve	30
• <b>Figura 20.</b> Dije për ekzistencën e kuadrit ligjor	31
• <b>Figura 21.</b> Efektiviteti i qeverisjes dhe sigurisë	31
• <b>Figura 22.</b> Përjetimi i një dëmi mjedisor	32
• <b>Figura 23.</b> Raportimi i dëmit mjedisor	32
• <b>Figura 24.</b> Rreth cilave çështje të lidhura me qeverisjen dhe sigurinë mjedisore do të donit të kishit më shumë informacion?	33
• <b>Figura 25.</b> Tematikat që pjesëmarrësit kërkojnë më shumë informacion sipas qarqeve më të përfaqësuar në anketë	33
• <b>Figura 26.</b> Ndikimi i shkeljeve mjedisore	35
• <b>Figura 27.</b> Grupet që preken më shumë	35
• <b>Figura 28.</b> Raste të përjetimit të shkeljeve mjedisore sipas gjinisë	36

• <b>Figura 29.</b> Shkeljet mjedisore shkaktojnë pabarazi	36
• <b>Figura 30.</b> Ndikimi i normave shoqërore dhe kulturore	36
• <b>Figura 31.</b> Politikat dhe ndëshkimet të marrin parasysh qasjen gjinore	37
• <b>Figura 32.</b> A ndikon korrupsioni shkeljet mjedisore?	39
• <b>Figura 33.</b> Dijeni të rasteve të korrupsionit	39
• <b>Figura 34.</b> Dijeni të rasteve të korrupsionit sipas qarkut të banimit, në qarqet më të përfaqësuara	39
• <b>Figura 35.</b> Zbatimi i ligjit dhe korrupsioni	40
• <b>Figura 36.</b> Adresimi i korrupsionit për të ulur nr e shkeljeve mjedisore	40
• <b>Figura 37.</b> Sa të kënaqur jeni me rolin e agjencive ligj-zbatuese në luftën ndaj korrupsionit në shkeljet/ krimet mjedisore (Bashkia, Inspektoriati Mjedisor, Policia, Prokuroria, Gjykata)?	41
• <b>Figura 38.</b> A njihni OJF që luftojnë krimin mjedisor?	41
• <b>Figura 39.</b> Adresimi i korrupsionit për të ulur nr e shkeljeve mjedisore	41
• <b>Figura 40.</b> A e keni raportur rastin e ryshfetit?	42
• <b>Figura 41.</b> Sa i rëndësishëm është bashkëpunimi midis institucioneve dhe publikut në adresimin e korrupsionit lidhur me shkeljet/ krimet mjedisore?	43
• <b>Figura 42.</b> Rëndësia e pjesëmarrjes së publikut	45
• <b>Figura 43.</b> Kryerja e fushatave të ndërgjegjësimit	45
• <b>Figura 44.</b> Cila nga këto fusha mendoni se kërkon përmirësim për të forcuar qeverisjen mjedisore dhe rritur sigurinë mjedisore?	45
• <b>Figura 45.</b> A do të ishit të hapur të merrni pjesë aktive në nismat lokale për rritjen e sigurisë dhe mirë-qeverisjen mjedisore ose të jeni vullnetar/e në organizata mjedisore?	45

## Lista e shkurtimeve

- **EUROPOL** – Agjencia e Bashkimit Evropian për Bashkëpunim në Zbatimin e Ligjit
- **DCAF** – Qendra e Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura
- **UN Women** – Organizmi i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave
- **NATO** – Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
- **OJF** – Organizata Jo-Fitimprurëse



